



Salla: 52 milionë euro në mbështetje të fermerëve, skema përshtatet sipas nevojave të tyre

Faqe 2

Kompensimi i fermerëve, nis zbatim në qershor 2026! Fermerët dorëzojnë çdo 6 muaj faturat në tatime, marrin 10% mbrapsht

Faqe 4

“Nga Bashkimi në Sukses: 25 Janari i Unionit Shqiptar të Kursim-Kredive”

Faqe 4

KASH
KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit janar 2026 **Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 526** Çmimi 125 lekë E përdijavshme e pavarur

BUJQËSIA DUHET TË PLOTËSOJE SIGURINË USHQIMORE TË BE-SË RAMA: FERMERËT TË ORIENTOHEM NË SHFRYTËZIMIN E FONDEVE, GARANCIA SOVRANE OFRON 1 MILIARD EURO MBËSHTETJE

Në një takim me fermerët në Divjakë për Skemën Kombëtare 2026, kryeministri Edi Rama u shpreh se së pari fermerët duhet të orientohen drejt mundësive të pashfrytëzuara të financimit. Ndërsa theksoi se anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon që sot të fillojnë përgatitjet në sektorin e bujqësisë, për atë që do të ndodhë nesër

GOSP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Çdo fermer me NIPT do të dëmshpërblehet pas evidentimit të plotë të dëmeve

Faqe 5

INTERVISTA

Kreu i KASH Rrapaj: Dobitë e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi



Faqe 6

FED INVEST

ABA Online feston 5-vjetorin - Një platformë që bashkon dijen, teknologjinë dhe bujqësinë moderne

Faqe 3

TEMA TË DITËS

- Guri për ATSH: Nisin përgatitjet për riakreditimin e masave të IPARD III, vlerësimi i BE-së në qershor Fq.2
- Gjylameti në krye të AKU: Siguria ushqimore, pjesë kyçe e integritetit në BE Fq.2
- Modeli holandez i zhvillimit bujqësor pilotohet në Rajonin e Korçës Fq.5
- Salla diskuton me homologun turk skemat e sigurimeve bujqësore sipas modelit TARSIM Fq.5
- Startup-et do të përfitojnë mbështetje financiare dhe shërbime mbështetëse për zhvillimin e bizneseve të tyre Fq.7
- Kalendari bujqësor, muaji shkurt 2026 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

INTEGRIMI

Dhuka: Plan gradual për arritjen e standardeve evropiane të sigurisë ushqimore

Faqe 5



TEMA TË DITËS

Salla: 52 milionë euro në mbështetje të fermerëve, skema përshtatet sipas nevojave të tyre

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, njoftoi se ka nisur një tur dëgjësash me fermerët



në të gjithë vendin, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të skemës kombëtare të mbështetjes së fermerëve e nevojat që ata kanë.

Gjatë vizitës në Kavajë dhe Rogozhinë, ministri Salla theksoi rëndësinë e dëgjimit të fermerëve dhe përfshirjes

së tyre në përshtatjen e skemës, duke u mundësuar të japin sugjerimet dhe të evidentojnë çdo problema-



tikë lidhur me skemën apo përfitimet e tyre.

“Kemi vendosur një buxhet rreth 52 milionë euro për këtë skemë, që fermerët të aplikojnë dhe përfitojnë,” tha ministri, duke shtuar se turi do të vazhdojë në të gjithë bashkitë e Shqipërisë.

Në lidhje me dëmet e shkaktuara nga përmytjet në disa zona, ministri Salla njoftoi se qeveria ka vendosur një paketë financiare për të gjithë fermerët e dëmtuar. Ai bëri të ditur se po punohet për evidentimin e plotë të dëmeve në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, emergjencën civile dhe bashkitë, për të dalë me vendime konkrete dhe shpërblime të shpejta për fermerët e prekur.

“Siç e keni parë para disa ditësh, ne kemi vendosur një paketë financiare nga qeveria shqiptare në mënyrë që të gjithë të dëmtuarit do të jenë të përfshirë në paketën financiare. Ne jemi duke bërë evidentimin e dëmeve të shkaktuara bashkë me Ministrinë e Bujqësisë, emergjencën civile dhe bashkitë në mënyrë që ne të kemi një evidentim të plotë dhe të dalim me një vendim, i cili do të jetë publik shumë shpejt”, deklaroi ai.

Gjylameti në krye të AKU: Siguria ushqimore, pjesë kyçe e integritetit në BE

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla prezantoi drejtoreshën e re të përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), Blerina Gjylameti, në një takim me ekipin drejtues të institucionit.

Gjatë prezantimit, ministri Salla vuri theksin te rëndësia e drejtimit dhe menaxhimit efikas të institucionit, si dhe te roli kyç i sigurisë ushqimore në procesin e integritetit evropian.

“Ndamë me ekipin drejtues rëndësinë e menaxhimit efikas të punës dhe vëmendjen e cila mbetet një prioritet kombëtar dhe një shtyllë thelbësore e procesit tonë të integritetit në Bashkimin Evropian”, u shpreh ministri.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural theksoi se AKU do të vijojë të forcojë rolin e

tij institucional në funksion të qytetarëve dhe biznesit. “AKU

theksoi Salla.

Në përfundim, ministri



do të vijojë të forcojë besimin e publikut dhe rolin e tij kyç në garantimin e ushqimit të sigurt dhe cilësor, përmes kontrolleve të bazuara në risk dhe rritjes së profesionalizmit të inspektimeve, në shërbim të konsumatorëve dhe biznesit”,

Salla shprehu mirënjohjen për drejtuesin e deritanishëm të institucionit dhe e falënderoi për angazhimin dhe kontributin e dhënë, si dhe i uroi suksese në detyrën e re drejtoreshës së përgjithshme, Blerina Gjylameti.

Fshati Drisht në zonën e Postribës, njihet për prodhimin e qepës dhe lakrës, dy kultura që përbëjnë pjesë të rëndësishme të traditës bujqësore të zonës.

Fermerët e këtij fshati janë të angazhuar në përpunimin e tokave dhe kultivimin me përkujdesje të këtyre perimeve, duke ruajtur njohuritë

dhe metodat tradicionale që janë trashëguar brez pas brezi.

“Lakrën dhe qepën e kultivojmë me kohë”, u shpreh

fermeri Nuh Dushaj.

“Në këtë fshat prej vitesh janë mbjellë qepë e cila është e njohur si qepa e Drishtit”, tha

Guri për ATSH: Nisin përgatitjet për riakreditimin e masave të IPARD III, vlerësimi i BE-së në qershor

Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Fatmir Guri, gjatë një interviste për Agjencinë Telegrafike Shqiptare deklaroi se ka nisur procesin për riakreditimin e masave ekzistuese dhe akreditimin e masave të reja të IPARD III, program ky që mbështet zhvillimin rural dhe përafrimin e bujqësisë shqiptare me standardet e Bashkimit Evropian.

Sipas Gurit, që nga viti 2024 MBZHR ka bashkëpunuar me partnerët evropianë për hartimin e një plani masash, i cili është rishikuar dhe në shtator të vitit 2025 është pranuar zyrtarisht. “Ky plan masash u pranua, ndërsa i janë shtuar edhe komentet dhe sugjerimet e partnerëve evropianë, për të siguruar një përafrim sa më të plotë me kërkesat e BE-së”, tha ai.

Zëvendësministri bëri të ditur se në dhjetor 2025 Shqipëria organizoi takimin e monitorimit, ku partnerët evropianë u shprehën se ka ardhur koha për të filluar hapat e mëtejshëm për akreditimin e masave ekzistuese dhe masave të reja të IPARD III.

“Duke nisur këtë vit, MB-

ZHR dhe institucionet e linjës do të fillojnë hap pas hapi procedurën e riakreditimit të masave të IPARD III, dhe në bazë të këtij procesi, në përfundim të tij do të kemi edhe vlerësimin nga BE për hapjen e aplikimeve për IPARD III”,



tha ai.

Guri shtoi se synimi është që deri në fund të qershorit 2026 të kemi vlerësimin e BE, i cili do të mundësojë nisjen e aplikimeve për financimet e IPARD III dhe mbështetjen e fermerëve dhe blegtorëve shqiptarë për investime në sektorët

bujqësor, blegtoral dhe rural.

Ai theksoi se programi IPARD III është një instrument kyç për modernizimin e bujqësisë dhe përmirësimin e kapaciteteve të prodhimit, duke krijuar mundësi për përmirësimin e standardeve dhe

përfaqësimin e Shqipërisë në tregjet evropiane.

“Ky proces nuk është vetëm administrativ, por një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me BE, duke siguruar që masat e mbështetjes të jenë efektive dhe të përputhshme me kërkesat evropiane”, përfundoi Guri.

Salla: Akses më i gjerë i fermerëve në Skemën Kombëtare 2026

Skema Kombëtare 2026 do të hartohet për të garantuar që çdo fermer me NIPT, si dhe fermerët e organizuar në grupe, të kenë akses sa më të gjerë dhe më të drejtë në mbështetjen direkte.

Kështu bëri të ditur ministri për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Andis Salla, i cili zhvilloi një dëgjese me fermerët e bashkisë Pogradec, si pjesë e procesit të bashkëhartimit të Skemës Kombëtare 2026, për ta ndërtuar atë mbi nevojat reale të terrenit.

Salla theksoi se fokusi është “rritja e standardeve të prodhimit Made in Albania, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian në mënyrë që konsumatorët shqiptarë të kenë cilësi evropiane në tryezë e po ashtu fermerët të mbështeten ashtu

si në BE, dhe produktet vendase të zgjerojnë hartën e eksporteve, duke e bërë bujqësi

lartë krahasuar me një vit më parë.

Turi i dëgjësave me



inë shqiptare më konkurruese në tregjet rajonale dhe evropiane.

Skema 2026 do të ketë një buxhet fillestar prej 5.2 miliardë lekësh, ose 16% më të

fermerët do të vijojë edhe në qarqe të tjera të vendit, duke synuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të komuniteteve bujqësore në hartimin e Skemës Kombëtare 2026.

Prodhimi i qepës dhe lakrës në Drisht - Fermerët ruajnë traditën, specialistët theksojnë interesin e madh

dhe metodat tradicionale që janë trashëguar brez pas brezi.

“Lakrën dhe qepën e kultivojmë me kohë”, u shpreh

fermeri Nuh Dushaj.

“Në këtë fshat prej vitesh janë mbjellë qepë e cila është e njohur si qepa e Drishtit”, tha

fermeri Maliq Curri.

Sipas specialistëve të bujqësisë, fermerët në Shkodër po tregojnë një interes të madh

për zhvillimin e bujqësisë, duke synuar të rrisin produktivitetin dhe të përmirësojnë teknikat e kultivimit.

“Interesi i fermerëve për ndihmën e specialistëve është shtuar”, u shpreh Sherif Brahaj, Specialist pranë Drejtorisë së Bujqësisë në Shkodër.

Postriba njihet si një zonë me prodhimtari të lartë bujqësore, ku fermerët kultivojnë tokën me përkushtim dhe sigurojnë prodhime cilësore.

SKEMA KOMBËTARE NË BUJQËSI

BUJQËSIA DUHET TË PLOTËSOJE SIGURINË USHQIMORE TË BE-SË

RAMA: FERMERËT TË ORIENTOHEM NË SHFRYTËZIMIN E FONDEVE, GARANCIA SOVRANE OFRON 1 MILIARD EURO MBËSHTETJE

Në një takim me fermerët në Divjakë për Skemën Kombëtare 2026, kryeministri Edi Rama u shpreh se së pari fermerët duhet të orientohehen drejt mundësive të pashfrytëzuara të financimit. Ndërsa theksoi se anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon që sot të fillojnë përgatitjet në sektorin e bujqësisë, për atë që do të ndodhë nesër

Kryeministri Edi Rama deklaroi se qeveria ka vendosur në dispozicion të fermerëve Garancinë Sovrane e cila mund të shkojë deri në 1 miliard euro, por që nuk është shfrytëzuar sa duhet nga fermerët.

Në një takim me fermerët në Divjakë për Skemën Kombëtare 2026, Rama u shpreh e së pari fermerët duhet të orientohehen drejt mundësive të pashfrytëzuara të financimit.

“Jemi mësuar t’i referohemi buxhetit të shtetit, por buxheti i shtetit tanimë është vetëm njëri nga komponentët e zinxhirit të financimeve të bujqësisë dhe natyrisht që është më i thjeshti sepse përcaktohet nga qeveria dhe miratohet nga parlamenti”, tha ai.

Ndërkohë, Rama solli në vëmendje faktin se komponentët e tjerë janë pak më të vështirë por do të bëhen gjithmonë e më të pranishëm, ndaj të gjithë duhet të aftësohen për

t’i shfrytëzuar.

“Sot në vendin tonë çështja e financimit të projekteve dhe punëve të secilit nuk është problem në aspektin financiar, sepse paratë janë. Ajo që është problem është mungesa e informacionit dhe mungesa e përgatitjes për t’i thithur ato para. E njëjta gjë vlen edhe për atë që lidhet me BE-në. Ne do kemi gjithmonë e më shumë fonde nga BE, por këto fonde lidhen drejtpërdrejtë me sa të aftë jemi ne që t’i thithim dhe sa të aftë dhe përgatitur janë sektorët dhe sipërmarrësit”, tha Rama.

Duke folur mbi Garancinë Sovrane, Rama tha se në dispozicion të bujqësisë janë vendosur 250 milionë euro që mund të shkojnë edhe 1 miliard euro, në rast se do të konsumohen, përmes Bankës së Shqipërisë në bankat e nivelit të dytë.

“Të gjithë mund të shkojnë

dhe të marrin kredi që janë me garanci nga shteti dhe ku normat e interesit janë shumë më të ulëta se sa në bankat e nivelit të dytë. Kjo garanci është shfrytëzuar shumë pak”, tha Rama.

Ndaj ai kërkoi nga pushteti vendor që të jetë më shumë aktiv në bashkëpunimin me fermerët dhe bujqit për të adresuar këto financime.

“Nuk duhet të ketë asnjë problem në rast se duhet një komponent si agropërpunimi, grumbullimi, mekanikë apo logjistikë sepse financimi ekziston. Bashkitë dhe fermerët duhet të krijojnë nukle apo struktura të përbashkëta për të marrë këto financime. Shteti ka detyrë t’i qëndrojë pranë fshatit dhe këtij sektori dhe fermerëve më shumë se të tjerëve, pasi është një sektor që duhet të mbështetet për të funksionuar si duhet”, tha Rama, ndërsa ritheksoi nevojë e bashkimit të fermerëve.

Rama theksoi se anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon që sot të fillojnë përgatitjet në sektorin e bujqësisë, për atë që do të ndodhë nesër.

Kreu i qeverisë nënvizoi se në rast se nuk plotësohen kriteret e sigurisë ushqimore të Bashkimit Evropian, ndalohet shitja e produkteve, pasi bëhesh pjesë e BE-së.

“Në rast se nuk plotësohen kriteret e sigurisë ushqimore të BE-së, ndalon shitja këtu, nuk shet dot as këtu, jo më të shesësh atje, sepse je pjesë tregut të BE-së. Natyrisht që kjo vjen pas një periudhë 15-vjeçare. Në rast se ne do ta na duhen edhe 5 vjet që të jemi pjesë e BE-së pra, në 2040 fillon kjo. Por 15 vite kalojnë shumë shpejt”, tha Rama.

Rama theksoi se fermerët që të kenë sukses në një treg më të gjerë duhet të informohen dhe të bëhen gati për të marrë më shumë financim përmes

projekteve, si nga linja e kredisë sovranë të Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe nga fondet e Bashkimit Evropian.

“Mua më vjen mirë që edhe nga këto dëgjesa, çfarë kemi ne në dorë si qeveri nga pikëpamja e buxhetit, mbështetjes edhe sa i përket infrastrukturës që ka të bëjë me ujtitje, kullimin, mbrojtjen, ne do ta bëjmë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë duke i rritur financimet. Por për të bërë financim dhe për t’u bërë shumë më tepër të suksesshëm në gjithë këtë territori dhe në Shqipëri dhe për ta pasur suksesin të shpërndarë në gjithë këtë numër të caktuar kompanish, duhet që secili të informohet dhe të behet gati për të marrë më shumë financim. Më shumë financim nuk vjen nga buxheti, por vjen nga instrumente të tjerë nga linja e kredisë e Bankës së Shqipërisë, vjen nga Banka e Zhvillimit, nga agrokrediti,

nga fondet e BE-së, të gjitha këto duan projekte. Pa projekt thuaj çfarë të duash, duhet projekti, të tregosh ky është projekti këtë do të bëj unë dhe kështu do të nxjerr fitim”, tha Rama.

Ana tjetër, shtoi Rama, bashkitë duhet që me të gjithë ata që kanë interes për përpunim domatesh a përpunim frutash, të krijojnë ndërmarrjen përpunimit, ku bashkitë janë garantë të financimit për të marrë këto fonde.

Gjithashtu Rama foli edhe për ngritjen e ndërmarrjeve të vogla të agropërpunimit.

“Ngritja e ndërmarrje të voglave të agropërpunimit është një domosdoshmëri, është strategjike dhe duhet bërë tani për të krijuar vlerë të shtuar, për të mos patur asnjë problem në shitjen e prodhimit dhe për të qenë zot të çmimit në çdo kohë dhe për të imponuar tregun në çdo situatë”, tha Rama.

Salla: Eksportet bujqësore drejt konsolidimit, synojmë 1 miliard dollarë deri në vitin 2030

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, deklaroi se sektori i bujqësisë dhe agropërpunimit po shënon përmirësim të qëndrueshëm në eksport, duke u mbështetur në rritjen e standardeve, certifikimit dhe investimeve, me synimin që eksportet bujqësore të arrijnë në 1 miliard dollarë amerikanë deri në vitin 2030.

Gjatë përshëndetjes në aktivitetin “ExportON”, ministri Salla vlerësoi këtë platformë si një hap të rëndësishëm që bashkon në një tryezë të vetme politikat e eksportit, financimin, standardet, promovimin dhe pengesat reale të sektorit privat, veçanërisht në bujqësi dhe agropërpunim, ku potenciali i rritjes mbetet i lartë, por kërkesat për standarde janë gjithnjë e më të forta.

Salla theksoi se sot eksporti nuk përfaqëson vetëm shitjen e produkteve jashtë vendit, por lidhet ngushtë me besueshmërinë, certifikimin dhe garantimin e sigurisë për konsumatorin.

Sipas tij, raporti i eksporteve ndaj importeve ka arritur aktualisht në 1 me 3, nga 1 me 7 që ishte rreth një dekadë më parë, ndërsa objektivi afatmesëm i qeverisë është arritja e raportit një import me dy eksporte.

Ministri bëri të ditur se eksportet bujqësore shqiptare shtrihen sot në rreth 80 shtete, ku Bashkimi Evropian mbetet partneri kryesor tregtar, duke

përfaqësuar rreth 58% të vlerës totale të eksporteve bujqësore.

Ai vuri në dukje se struktura e eksporteve tregon qartë fushat ku Shqipëria ka avantazh konkurrues, me zarzavatet që zënë peshën më të madhe si në sasi ashtu edhe në vlerë, të ndjekura nga peshku dhe produktet e detit.

“Kjo tregon se jemi në rrugën e duhur, pasi në tregun e Bashkimit Evropian hapet dera vetëm kur plotësohen standardet, kontrollat, dokumentacioni dhe siguria e produktit”, theksoi Salla.

Ministri bëri të ditur se ak-

tualisht po punohet në disa drejtime paralele, ku një ndër prioritetet kryesore është përfundimi i plotë i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian, me synimin për finalizimin e transpozimit ligjor deri në vitin 2027 dhe konsolidimin e kontrollit zyrtar në nivel qendror dhe rajonal brenda vitit 2026.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm është digjitalizimi i kontrollit ushqimor, i cili do të mundësojë monitorim të vazhdueshëm, standardizim të të dhënave në kohë reale dhe rritje të transparencës, në shërbim si të konsumatorit ashtu edhe të eksportuesit.

Në këtë kuadër, Salla nënvizoi rëndësinë e investimeve në rrjetin laboratorik, modernizimin e laboratorëve rajonalë dhe forcimin e pikave të inspektimit kufitar, të cilat janë thelbësore për besueshmërinë e analizave dhe lehtësimin e procedurave të eksportit.

Ministri theksoi se për të arritur objektivin “Bujqësia 2030”, rritja e eksporteve kërkon domosdoshmërisht edhe investime të reja. Për këtë qëllim, përmes skemave kombëtare dhe së shpejti edhe nëpërmjet programit IP-ARD, do të mbështetet modernizimi i fermave dhe kapaciteteve të përpunimit.

Salla bëri të ditur se për vitin 2026 janë planifikuar rreth 2 miliardë lekë mbështetje investimi, me grante deri në 50% të vlerës së investimeve, si dhe instrumente financiare përmes Fondit të Garancisë Sovrane për subjektet agropërpunuese, duke krijuar një paketë të integruar mbështetjeje.

“Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë sistemin e standardeve dhe infrastrukturën mbështetëse. Ndërkohë, sektori privat duhet të investojë në cilësi, certifikim dhe organizim, sepse eksporti është një maratonë, jo një sprint. Së bashku duhet ta bëjmë Shqipërinë dhe produktin shqiptar një histori suksesi që lexohet në etiketë dhe provohet në treg, ‘Made in Albania’”, përfundoi ministri Salla.

ABA Online feston 5-vjetorin - Një platformë që bashkon dijen, teknologjinë dhe bujqësinë moderne

Platforma digjitale ABA Online, e mbështetur nga FED Invest, ka festuar 5-vjetorin e krijimit të saj, duke shënuar një rrugëtim të suksesshëm në shërbim të rritjes së dijes, inovacionit dhe përhapjes së praktikave moderne në sektorin bujqësor dhe agro-ushqimor në vend.

Që nga artikujt e parë informues e deri te demonstrimet praktike në terren, ABA Online është kthyer në një pikë referimi për fermerët, profe-

sionistët dhe të interesuarit, duke ndërtuar një komunitet të gjerë që beson te teknologjia dhe edukimi i vazhdueshëm.

Në 5 vite aktivitet, platforma ka arritur rezultate konkrete dhe të matshme. Sipas të dhënave zyrtare, ABA Online ka realizuar 112 trajnime pro-

fesionale, ndërsa në platformë janë regjistruar 23,210 përdorues nga e gjithë Shqipëria. Revista online e ABA-së numëron 11,079 ndjekës, ndërkohë që përmbajtja audiovizive përfshin 301 video dhe Reels me këshilla praktike për fermerët dhe bizneset agro-ushqimor.

Një tjetër komponent i rëndësishëm i punës së ABA Online janë 196 demonstrimet në fermë, të cilat kanë shërbyer për të afëruar teorinë me praktikën, si dhe rubrika “Pyet Ekspertin”, përmes së cilës janë ndihmuar drejtpërdrejt 5,704 klientë me këshillim profesional.

Drejtimesit e platformës theksojnë se këto shifra përfaqësojnë jo vetëm rritjen e ABA Online, por edhe forcimin e një komuniteti aktiv që ndan eksperiencën, njohuri dhe zgjidhje konkrete për zhvillimin e bujqësisë moderne në vend.

Me rastin e 5-vjetorit, ABA

Online ka shprehur mirënjohjen për partnerët strategjikë FED Invest, JICA dhe MEKI, si dhe për ekspertët, opinionistët dhe të gjithë kontribuuesit që kanë dhënë ndihmesën e tyre në këtë rrugëtim të përbashkët.

ABA Online synon që edhe në vitet në vijim të zgjerojë shërbimet e saj, të rrisë cilësinë e përmbajtjes dhe të forcojë rolin e teknologjisë dhe inovacionit në mbështetje të fermerëve dhe zhvillimit rural në Shqipëri.

AKTUALITET

Kompensimi i fermerëve, nis zbatim në qershor 2026! Fermerët dorëzojnë çdo 6 muaj faturat në tatime, marrin 10% mbrapsht

Fermerët duhet të marrin faturë nga grumbulluesit apo agroturizmat kur ju shesin produktet e tyre. Vetëm nëse kanë fatura do të përfitojnë kompensimin 10%. Drejtorja e Tatimeve njofton se faturat e gjashtëmujorit të parë, do të kompensohen brenda këtij viti, por duhet që fermerët të jenë të regjistruar me NIPT në tatime

Të gjithë fermerët e regjistruar në tatime dhe që i shesin produktet e tyre tek grumbulluesit, përpunuesit apo agroturizmat e certifikuar që janë të regjistruar për pagimin e TVSH-së, do të marrin kompensim për faturat e tyre për herë të parë këtë vit.

Administrata tatimore ka sqaruar sesi do të funksionojë skema e re. Konkretisht blerësi do t'i lëshojë faturën tatimore fermerit për mallrat ose shërbimet e blera, dhe nga vlera e shkruar në faturë do t'i kompensohet 10% fermerit. Pra nëse fermeri shet produkte me vlerë 100 mijë lekë, do të marrë si kompensim nga shteti 10% e faturës ose 10 mijë lekë. Gjithashtu fatura që lëshon grumbulluesi/përpunuesi duhet të ketë edhe NIPT-in e fermerit prodhues.

“Fermeri duhet të dorë-

zojë në Administratën Tatimore kërkesën për kompensim (elektronikisht ose nëpërmjet shërbimit postar), duke bashkëlidhur: Kopje të faturave të lëshuara nga blerësi i mallrave dhe shërbimeve bujqësore; Numrin e llogarisë së tij bankare”, sqarohet në njoftimin e drejtorisë së tatimeve.

Fermerët duhet t'i dorëzojnë faturat një herë në gjashtë muaj. Kompensimin për janar-qershor 2026, ata do e marrin brenda 31 dhjetorit të këtij viti, ndërsa për faturat e gjashtëmujorit e dytë të vitit, do e marrin deri në qershor të 2027-ës.

Kompensimi nga Administrata Tatimore kryhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga fermeri. Kërkesa mund të refuzohet në rast se, nuk është dorëzuar

brenda afatit apo kur nuk plotësohen kushtet.

Janë gati 100 mijë fermerë me NIPT në të gjithë vendin, por kompensimin do ta marrin vetëm ata që janë me NIPT në tatime, ndërsa të tjerët që e kanë në QKB nuk përfitojnë pasi futen tek kategoria e tregtarëve.

Gjithashtu Ministria e Bujqësisë po punon edhe për rishikimin e skemës Kombëtare të Mbështetjes për ta përshtatur me nevojat e fermerëve, ku pritet të preket edhe formula sesi bëhet mbështetja përmes naftës.

Për të mbështetur fermerët si në prodhimet bujqësore ashtu edhe në shtimin e fermave apo prodhimeve blegtorale, në buxhet për këtë vit janë parashikuar për skemën kombëtare 5.2 miliardë lekë, ose 52 milionë euro.

Produkte “Made in Albania” në BE - Rama: Mbështetje eksportuesve, hiqen burokracitë doganore

Kryeministri Edi Rama deklaroi se “Made in Albania” është një markë cilësie dhe një pasaportë për në Bashkimin Europian, ndaj dhe qeveria do t'i mbështesë fuqimisht të gjithë ata që do të synojnë marrjen e kësaj pasaporte. I pranishëm në tryezën e dialogut mes qeverisë dhe biznesit eksportues, ku u shpalos platforma e re ExportOn, kryeministri Rama kërkoi që të hiqet dorë nga konkurrenca me çmim të ulët dhe bizneset të fokusohen te konkurrenca me standard të lartë të certifikuar nga BE.

“Të gjitha kompanitë tona që janë në një process transformimi të vazhdueshëm është

e domosdoshme të mbajnë sytë nga çfarë I pret në një të ardhme jo shumë të largët ku Shqipëria do jetë anëtare e BE. Është një hapësirë mundësish por edhe sfidat të jashtëzakonshme. Kush nuk do di të adopotohet do jetë humbës. Sot jemi në nisje të një tjetër viti të rëndësishëm në BE. Jemi këtu për të mbështetur bashkë një nismë të AIDA, që tani është kthyer nga zyrë informacioni në mekanizëm mbështetje që orientojnë të gjithë ata që i adresohen. Me rëndësi për ekonominë tonë është domosdoshmëria për të rritur vlerën në vend, dhe një nga sfidat e AIDAs është mbështetja e eksporteve duke

mbështetur prodhimet made in Albania. Cojmë në nivel tjetër marrëdhënien me eksportuesit.

“Made in Albania” është një markë cilësie dhe një pasaportë për në BE, për këtë do të mbështesim gjithë ata që do synojnë të japin vetes këtë pasaportë duke hequr dorë nga ideja se konkurrenca me çmim të ulët mund ti cojë larg dhe duke u fokusuar te konkurrenca me standarde të larta. Mbështetja që do të japim për certifikimet ndërkombëtare është dicka që e shohim si një investim strategjik të shtetit, jo thjesht për ti kursyer binzesit disa lekë por për ta ndihmuar të futet në tregun europian.

"Paketa e Maleve", shpallen zonat me përparësi zhvillimi në Dibër, Memaliaj dhe Tepelenë

Në kuadër të programit “Paketa e Maleve”, Këshilli i Ministrave shpalli disa zona me përparësi zhvillimi të ekonomisë malore në bashkitë Dibër, Memaliaj dhe Tepelenë.

Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këto zona kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik; zhvillimin industrial dhe zhvillimin turistik.

Në bashkinë Dibër zonë me përparësi zhvillimi të ekonomisë malore janë shpallur në

Bjeshkët e Korabit, të Hinokës, të Gramës dhe të Zimurit.

Po ashtu, zona zhvillimore janë përcaktuar në fshatin Brezhdan, fshatin Kallë, fshatin Lashkizë, fshatin Lugje, në Lurë, në fshatin Qa (Prat), fshatin Sllatinë, në Lan – Lurë etj.

Zona zhvillimore në territorin e kësaj bashkie janë përcaktuar edhe në livadhet e Kallës – Vleshë, në luginën e lumit Drin, si dhe në fshatrat Selishtë, Luzni dhe Rabdisht.

Ndërsa në territorin e bashkisë Memaliaj janë shpallur zona zhvillimore në fshatrat Arrëz e Madhe, Maricaj dhe Vagalat, në njësinë administrative Buz, dhe në fshatin Rabie.

Në bashkinë Tepelenë janë shpallur zona me përparësi zhvillimi të ekonomisë malore sipërfaqe toke në njësinë administrative Kurvelesh, në njësinë administrative Lopës dhe në njësinë administrative Qendër-Tepelenë.

“Nga Bashkimi në Sukses: 25 Janari i Unionit Shqiptar të Kursim-Kredive”



Hyrja:

Më 25 janar 2002, një vizion i guximshëm u bë realitet në Shqipëri. 60 Shoqëri Kursim-Krediti u bashkuan për të krijuar Unionin Shqiptar të Kursim-Kredive (SHKK) – një institucion financiar 100% shqiptar, që do të sillte jo vetëm para, por mundësi, shpresë dhe zhvillim në zemrën e zonave rurale. Që nga ai moment, një histori suksesi dhe ndikimi social filloi të shkruhej, duke transformuar jetën e qindra komuniteteve shqiptare.

Një histori ndikimi që vazhdon

Për më shumë se dy dekada, SHKK ka qenë një motor zhvillimi për zonat rurale:

- Financim i qëndrueshëm për bujqësinë dhe modernizim

i mikrokreditimit;

- Krijim i strukturave të para të shoqërisë civile në fshat;

- Rritje e punësimit dhe fuqizimi ekonomik i komuniteteve lokale;

- Përmirësim i përfshirjes financiare dhe lehtësim i varfërisë.

Kapitali njerëzor dhe vlera e përbashkët

Përtej fondeve, SHKK ndërtoi një kapital njerëzor të jashtëzakonshëm – breza të ndryshëm, përvoja të larmishme dhe një përkushtim i përbashkët ndaj integritetit dhe përgjegjësisë sociale, duke bërë të mundur që çdo vendim të reflektonte nevojat reale të anëtarësisë.

Trashëgimia vazhdon me FED invest

Vlerat e SHKK-së u trasn-

metuan dhe u forcuan në krijimin e FED invest, një model i njohur i financës sociale në Shqipëri. Më shumë se 70% e shoqërive anëtare të Unioni SHKK iu bashkuan FED invest, duke vendosur standarde të reja profesionalizmi dhe zhvillimi financiar në vend.

Një përvjetor reflektimi dhe mirënjohjeje

25 Janari nuk është vetëm një datë në kalendar. Është një moment për të vlerësuar vizionin që nisi gjithçka, për të falenderuar punën që krijoi themelet dhe për të nderuar njerëzit që vazhdojnë të çojnë përpara këtë histori suksesi. SHKK dhe FED invest tregojnë se zhvillimi financiar dhe përgjegjësia sociale ecin dorë për dorë, duke transformuar jetën e komuniteteve shqiptare dhe duke hapur rrugën për një të ardhme më të ndritur.

AKU tërheq nga tregu produktin e qumështit formulë për foshnjat me prani bakteri

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit njoftoi se ka tërhequr nga tregu produktin “NAN 1 OPTIPRO”, qumësht formulë për foshnjat, pasi rezultoi me prani të bakterit cereulide.

Pas kryerjes së kontroleve dhe ndjekjes së gjurmueshmërisë, AKU ka bllokuar të gjithë sasinë në gjendje të produktit dhe atë të kthyer nga tregu, me destinacion asgjësimin e tij, ose kthimin në vendin e origjinës.

Referuar subjektit importues në Shqipëri, mbi tërheqjen nga tregu të lotit të formulës për foshnjë “NAN 1 OPTIPRO” 800g, njoftim ky i bërë nga kompania prodhuese “Nestle”, si masë parandaluese pas zbulimit të pranisë së bakterit

cereulide në këtë produkt në subjektin prodhues në Holandë, AKU ka bllokuar të gjithë

se nga verifikimet në terren është konstatuar se është kryer afishimi i njoftimit për kon-



sasinë në gjendje të produktit. Gjithashtu, AKU informon

sumatorin në supermarketet ku është tregtuar ky produkt.

Salla: Pa ndërprerje puna për stabilizimin e argjinaturave të dëmtuara nga shirat

Strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me bash-

të dëmtuara nga reshjet intensive të shiut, që preken zonën javën e kaluar.

ndau pamje nga puna e strukturave në terren për forcimin dhe rehabilitimin e plotë të dëmeve të shkaktuara nga reshjet.

Salla thekson se puna vijon pa ndërprerje për stabilizimin e argjinaturës së dëmtuar nga reshjet intensive. “Po shkon drejt përfundimit ndërhyrja në çarjen e parë në fshatin Hasturkas, ndërsa paralelisht vijojnë punimet edhe në zonën “Kasollja e patateve” për rehabilitimin e plotë të dëmtimeve”, bën të ditur ministri.

Ai shton se ndërhyrja do të realizohet në çdo argjinaturë të dëmtuar, për të garantuar mbrojtjen e tokës bujqësore dhe sigurinë e komuniteteve.



kinë e Fierit, po vijojnë punën për stabilizimin e argjinaturave

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla

INFORMACIONE

Modeli holandez i zhvillimit bujqësor pilotohet në Rajonin e Korçës

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në kuadër të projektit 'Toka', me bashkitë Devoll, Ersekë, Maliq, Pogradec dhe Korçë, si dhe me Universitetin e Korçës, duke hapur rrugën për zbatimin e një modeli të ri bashkëpunimi për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale.

Projekti 'Toka' financohet nga Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), në partneritet me Universitetin Holandez të Kërkimeve Wageningen, dhe do të pilotohet në Rajonin

e Korçës mbi bazën e Modelit të Diamantit Holandez.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, ministri Salla theksoi se ky projekt përfaqëson një qasje të re në zhvillimin bujqësor. "Projekti 'Toka' krijon një model bashkëpunimi që lidh institucionet, dijen shkencore, inovacionin dhe fermerët, për të ndërtuar një bujqësi moderne dhe konkurruese", u shpreh ai.

Sipas Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, projekti synon hartimin e një rruge zhvillimi për eko-bujqësinë, ndërtimin e Sistemit të Njohurive dhe Informacionit në

Bujqësi, forcimin e sigurisë ushqimore, si dhe rritjen e kapaciteteve në arsim dhe kërkim shkencor. "Ky bashkëpunim është një hap konkret drejt një sektori bujqësor të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Europian", theksoi Salla.

Të pranishëm gjatë eventit ishin edhe Kryetari i Kuvendit dhe njëherazi drejtuesi politik i qarkut Korçë, Niko Peleshi, kryebashkiakët Sotirak Filo, Eduard Duro, Gëzim Topçiu, Erion Isai, Ilir Xhakolli, rektori i Universitetit të Korçës, si dhe përfaqësues nga AADF.



Dhuka: Plan gradual për arritjen e standardeve evropiane të sigurisë ushqimore

Ministria e Shtetit dhe Kryenegociatorja, Majlinda Dhuka deklaroi se Shqipëria ka ende shumë për të bërë në fushën e sigurisë ushqimore ose cilësisë së ushqimit.

Duke iu përgjigjur interesit të gazetarëve lidhur me kushtin e Bashkimit Evropian për sigurinë ushqimore, Dhuka tha se "në fushën e produkteve si mishi, peshku, veza, qumështi dhe nënproduktet e qumështit BE ka standarde të përcaktuara dhe të arta të higjienës së prodhimit, të grumbullimit, përpunimit, eksportimit apo të vendosjes në treg".

"Këto standarde shumë të mira sigurisht që janë për të gjitha vendet anëtare të BE-së njëherësh edhe për Shqipërinë janë të njëjtat standarde teksa i afrohet tregut të përbashkët evropian dhe synon t'i vendosë produktet e veta në këtë treg", theksoi Dhuka.

Njëkohësisht, vijoi Dhuka, kur Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së do të bëhet pjesë e këtij tregu, tregut të përbashkët evropian dhe rregullat do të zbatohen si brenda në Shqipëri, ashtu edhe për produktet që çojmë në vendet e BE-së.

"Në këtë kuptim, është koha tani që të gjithë së bashku nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të gjithë fermerët, grumbulluesit, prodhuesit, përpunuesit, eksportuesit, tregtarët me shumicë, me pakicë të punojmë për t'iu afruar këtyre standardeve të

BE-së", nënvizoi Dhuka.

Dhuka informoi se "po punojmë së bashku me MB-ZHR për të ndërtuar një plan gradual të afrimit të standardeve të sigurisë ushqimore në këtë grup produktesh, por

Shqipërisë për ta transformuar bujqësinë shqiptare duke futur standardin evropian në prodhim, grumbullim, në përpunim, në tregtim, në eksportim edhe më shumë nga tani".

Sipas saj, kjo është një prak-



edhe më gjerë".

Kryenegociatorja Dhuka bëri të ditur se "i kemi kërkuar Komisionit Evropian kohën e nevojshme për të realizuar hapa të vegjël, por sistematikë dhe të sigurt në drejtim të këtyre standardeve, sepse në një pjesë të rasteve kjo do të thotë që disa prodhues, përpunues, grumbullues, eksportues do të duhet të përmirësojnë pikat e tyre të prodhimit, grumbullimit, mjetet e transportimit të produkteve e të tjera si këto".

Më tej Dhuka vuri në dukje se "jemi në bisedime me Komisionin Evropian dhe vendet anëtare në lidhje me kohën e nevojshme që i duhet

tikë që e kanë ndjekur edhe vende të tjera që janë anëtarësuar para Shqipërisë në BE.

"Komunikimi me Komisionin Evropian vazhdon. Ne do të kemi mundësi që të diskutojmë përsëri së bashku në lidhje me rezultatet e këtij komunikimi me kohën që kemi në dispozicion, me hapat që duhet të bëjmë sot, e kështu me radhë, në mënyrë sistematike, gradualisht, përgjatë gjithë kësaj kurbe transformimi", tha Dhuka.

Nga ana tjetër, shtoi ajo, kjo është një mundësi e madhe për bujqësinë shqiptare për t'u transformuar drejt bujqësisë së një vendi që merr pjesë në tregun evropian.

Çdo fermer me NIPT do të dëmshpërblehet pas evidentimit të plotë të dëmeve

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, zhvilloi një takim me fermerët e Bashkisë Maliq, në përgjigje të kërkesës së tyre për bashkëbisedim lidhur me dëmet e shkaktuara nga reshjet intensive të ditëve të fundit.

Gjatë takimit, ministri Salla

përblehet," u shpreh ministri.

Duke folur për infrastrukturën e dëmtuar, ministri Salla sqaroi se problematikat me argjinaturat janë trajtuar me ndërhyrje të shpejta, ndërsa theksoi se do të shikohet mundësia për investime në të gjitha argjinaturat e dëmtuara.



theksoi se procesi i evidentimit të dëmeve vijon në terren, në bashkëpunim me bashkitë, bordet e kullimit dhe Emergjencat Civile.

"Sapo të kemi pasqyrën e plotë të dëmeve dhe informacionin nga bashkitë për zonat përkatëse, do të veprojmë menjëherë me vendim qeverie për të mbështetur fermerët. Çdo fermer me NIPT do të dëmsh-

Ministri Salla informoi fermerët edhe për mbështetjen financiare përmes Skemës Kombëtare. "Ne kemi nisur dëgjuesat për Skemën Kombëtare. Bëhet fjalë për një fond prej 52 milionë eurosh në mbështetje të fermerëve, për t'u dhënë mundësi reale përfitimi nga shteti," theksoi ai.

Sipas ministrit, qeveria ka rritur çdo vit buxhetin për mbështetjen e fermerëve. "Kemi

mbështetur 65 mijë fermerë në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe ky numër është rritur vit pas viti, paralelisht me rritjen e buxhetit. Këtë vit kemi përfshirë edhe mbështetjen prej 10% të faturimit, nga 1 janari deri më 31 dhjetor. Me faturat e depozituara periodikisht, fermerët do të përfitojnë automatikisht 10% të vlerës së faturimit," sqaroi Salla.

Ai nënvizoi se dëgjuesat me fermerët janë thelbësore për përshatjen e politikave me nevojat reale të terrenit dhe me legjislacionin e Bashkimit Europian. "Po i dëgjojmë fermerët, po marrim sugjerimet e tyre për skemën e re dhe po përgatisim sektorin që të jetë gati në vitin 2027, jo vetëm për orientimin e fermerëve, por edhe për mbështetjen e tyre dhe forcimin e sigurisë ushqimore," tha ministri.

Në përfundim, ministri Salla garantoi se qeveria ka parashikuar një paketë të posaçme financiare për përballimin e dëmeve nga përmbytjet. "Kemi hartuar një paketë financiare për mbështetjen e të gjitha dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e fundit dhe do të jemi pranë fermerëve në çdo fazë," përfundoi ai.

Salla diskuton me homologun turk skemat e sigurimeve bujqësore sipas modelit TARSIM

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla zhvilloi një takim me ministrin e Bujqësisë dhe Pylltarisë të Turqisë, İbrahim Yumaklı, gjatë qëndrimit të tij në Berlin, në kuadër të Forumit Global për Bujqësinë dhe Ushqimin (GFFA) 2026.

Salla bëri të ditur se, gjatë takimit u diskutua për forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në sektorët kyç të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

"Ndamë vlerësimin për marrëdhëniet Shqipëri-Turqi dhe diskutuam forcimin e bashkëpunimit në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore, si edhe të skemave të sigurimeve bujqësore sipas modelit TARSIM, duke riafirmuar partneritetin e qëndrueshëm mes dy vendeve",

deklaroi ministri Salla.

Ai theksoi rëndësinë e shkëmbimit të eksperiencave dhe bashkëpunimit teknik për

mbrojtjen nga rreziqet natyrore.

Takimi mes ministrave të Shqipërisë dhe Turqisë përfaqëson një hap konkret në



të përmirësuar praktikat e prodhimit bujqësor dhe sistemet e sigurimeve në sektorin e bujqësisë, duke synuar rritjen e qëndrueshmërisë së fermerëve dhe

thellimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe në përfundim të partneritetit rajonal për sigurinë ushqimore dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Sugjerime dhe kërkesa nga fermerët për Skemën Kombëtare të mbështetjes

Në takimin me fermerët në Divjakë për Skemën Kombëtare 2026, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla deklaroi se po rishikohet plani i mbështetjes duke marrë në konsideratë kërkesat dhe sugjerimet e fermerëve. Gjatë fjalës së tij, Salla theksoi se deri më tani janë zhvilluar 18 takime me fermerët në qarqe të ndryshme të vendit, nga 23 të planifikuara gjithsej, duke nënvizuar se dëgjuesat do të vijnë në çdo qark. "Komentet dhe sugjerimet e fermerëve janë të

domosdoshme dhe shumë të dobishme për hartimin e Skemës Kombëtare 2026, sipas kërkesave reale të terrenit," u shpreh ai. Ministri Salla u ndal edhe te çështjet konkrete të adresuara gjatë dëgjësive. "Janë shumë të domosdoshme dhe të dobishme që ne ta rishikojmë pjesën e mbështetjes dhe mënyrën si do të jemi ndaj aplikantëve, për të ulur numrin e krerëve për bagëti në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë fermerë. Kemi marrë sugjerime për bletarinë dhe kërkesa që lidhen me certifikatat e pro-

nësisë dhe kontratat e tokave me qira", deklaroi Salla. Ai bëri të ditur se këto sugjerime po analizohen në mënyrë të strukturuar. "Jemi duke i rishikuar, kemi bërë një plan me AZHBR dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe do të shikojmë atë që na sugjeroni, për t'i përafëruar edhe me skemën e naftës, ku kemi pasur problematike të shtuara sipas propozimeve të fermerëve", tha Salla. Ministri Salla theksoi gjithashtu nevojën për sinkronizim të të gjitha instrumenteve mbështetëse.

INTERVISTA

Kreu i KASH Rrapaj: Dobitë e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi

Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi për vitin 2025 përfaqësoi një nga instrumentet kryesore të politikës bujqësore të shtetit shqiptar, për të rritur prodhimin vendas, për të përmirësuar të ardhurat e fermerëve dhe për të modernizuar sektorin.

Në një mjedis të rritjes së kostove të inputeve bujqësore në rajon dhe më gjerë, të konkurrencës nga importet dhe të nevojës për përafrim të shpejtë me standardet e Bashkimit European, kjo skemë synoi të japë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare aty ku bujqësia dhe blegtoia shqiptare kishin më shumë nevojë.



Dobitë më të menjëhershme të skemës janë financiare. Subvencionet për sipërfaqe të mbjellë, për krerë blegtoralë, për sera, për mekanizim dhe për investime në teknologji ndihmojnë në uljen e kostos për njësi prodhimi dhe rrisin fitimin neto të fermerit. Në shumë zona rurale, kjo mbështetje shërbeu si burim i rëndësishëm likuiditeti, duke stabilizuar ekonominë familjare dhe duke parandaluar braktisjen e tokës. Përfituan më shumë se 53 mijë fermerë për një shumë tërësore mbi 33 milionë euro.

Skema kushtëzoi përfitimin me regjistrimin e aktivitetit, dokumentimin e sipërfaqeve, të numrit të krerëve dhe të prodhimit. Kjo nxiti formalizimin, rrit transparencën dhe zgjeron bazën e të dhënave për politikë publike. Formalizimi sjell edhe përfitime afatgjata: akses më të lehtë në financim bankar, sigurime bujqësore dhe programe të tjera kombëtare apo europiane.

Duke orientuar mbështetjen drejt kulturave strategjike (drithëra, perime, fruta, ulliri, vreshta) dhe blegtorisë, Skema Kombëtare ndikoi drejtpërdrejt në rritjen e ofertës vendase. Kjo ndihmon në uljen e varësisë nga importet, në përmirësimin e bilancit tregtar agro-ushqimor dhe në stabilizimin e çmimeve për konsumatorin.

Mbështetja për pajisje bujqësore, sisteme vaditjeje, sera, magazinim dhe përpunim nxiti kalimin nga bujqësia tradicionale drejt asaj më të mekanizuar dhe më produktive. Modernizimi rrit irendimentin, përmirësoi cilësinë e produkteve dhe zvogëloi humbjet pas vjeljes, duke i bërë fermat shqiptare më konkurruese në treg.

Përmes investimeve në infrastrukturë të mbështetura nga Skema Kombëtare 2025, u kon-

trolluan më mirë sëmundjet bimore dhe shtazore. Duke sjellë praktika më të mira bujqësore dhe blegtorale, Skema ndihmoi në rritjen e standardeve të prodhimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për aksesin në tregjet e BE-së dhe për besimin e konsumatorit vendas.

Rritja e aktivitetit bujqësor dhe investimet e reja krijuan vende pune sezonale dhe të përhershme në prodhim, përpunim dhe shërbime mbështetëse

këtë vit, mbështetja për fermerët llogaritet në vlerën e 1.5 miliardë lekëve ose 16 milionë euro.

CMG: Z. Rrapaj, sipas Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), deri tani, për vitin e kaluar 2025, mbi 53 mijë fermerë në të gjithë vendin kanë marrë financim nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2025. Numri i duhur? Duhej të ishin më shumë fermerë?

Agim Rrapaj: Ata që e kanë mundësinë për të marrë subvencion përmes skemës kombëtare janë rreth 100 mijë fermerë.

Këta plotësojnë kriteret për të marrë subvencion, pasi janë të pajisur me një dokument që është NIPT-i i fermerit dhe që është kushti kryesor për të marrë subvencionin.

Njëkohësisht, duhet të kemi parasysh se fragmentarizimi i tokës që ne kemi dhe numri i madh i fermerëve bën që të kemi një numër të konsiderueshëm përfuturash potencialë.

Kemi më shumë se 100 mijë fermerë që duhet të mar-

në bujqësi. Kjo ndikon pozitivisht në frenimin e migrimit nga fshati, në ruajtjen e strukturës



demografike dhe në zhvillimin ekonomik të territorit.

Skema nuk ndikoi vetëm te prodhimi primar, por edhe te hallkat pasuese: grumbullimi, magazinimi, përpunimi dhe marketingu. Kjo forcoi zinxhirin e vlerës, rriti shtesën e vlerës brenda vendit dhe përmirësoi pozicionin e produkteve shqiptare në tregjet rajonale.

Struktura e Skemës Kombëtare 2025 pasqyroi parime të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së: mbështetje direkte, orientim drejt rezultateve, formalizim dhe standarde. Kjo e përgatiti sektorin për integrim gradual në mekanizmat europianë të financimit dhe konkurrencës.

Për vitin 2026, fondet shtetërore për sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë janë 16.3 miliardë lekë, me një rritje prej 11.3 përqind, ose 11 milionë euro më shumë për fermerët, përpunuesit dhe peshkatarët.

Buxheti i Shtetit i këtij viti parashikon që fermerëve t'u shpërndajë rreth 5.2 miliardë lekë ose 55 milionë euro në formën e subvencioneve dhe granteve. Ndërkohë që nga kompensimi me 10 përqind i TVSH-së për inputet bujqësore

rin subvencion, për arsye se kontribuojnë në sektorët e bujqësisë dhe të sektorit të ekonomisë së ushqimit në tërësi.

Muajt nëntor dhe dhjetor janë muajt më intensivë, kur fermerët marrin rimbursimin. A janë shumë fermerët që përfutuan?

Mendoj se më shumë duhet të ishin, për arsye se bujqësia dhe sektorët e tjerë të lidhur me të kanë nevojë për këtë subvencion për arsye objektive dhe subjektive.

Ndër arsyet objektive është fakti që fermerët tanë ndeshen me konkurrencë të vazhdueshme përsa i përket importit të produkteve; ndeshen me një konkurrencë të pandershme përsa i përket informalitetit që ekziston në këtë sektor.

Njëkohësisht, kushtet klimatike janë të tilla që po dëmtojnë një pjesë të mirë të prodhimeve të fushës dhe jo vetëm. Gjithashtu, edhe sëmundshmëria te blegtoia është më e evidente.

Të gjithë këta faktorë së bashku bëjnë që faktikisht fermerët të kërkojnë më shumë subvencion, ndihmë direkte nga shteti, për të ekuilibruar situatën në bizneset e tyre.

Dhe unë mendoj që është më e udhës që Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) duhet të intensifikojë punën, në mënyrë të tillë që të gjithë fermerët që janë shpallur fitues të kenë mundësinë të dis-bursohen sa më shpejt.

CMG: Edhe pse Skema Kombëtare i ka dhënë më shumë prioritet financimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, të cilat përfitojnë në masën 100%, ende kemi shumë pak shoqëri të tilla. Pse?

Agim Rrapaj: Ky është problemi më i madh për t'u diskutuar. Dhe kjo lidhet ngushtë me procesin e kooperimit, i cili është një proces që nuk ka filluar ashtu siç duhet dhe në përmasat që duhet të zhvillohej.

Nuk është zhvilluar sikurse duhej, për arsye se për këtë proces nuk është punuar në front. Duhej që të punonin të gjitha institucionet, me objektivin final që të shtonin numrin e tyre dhe t'i konsolidonin këto shoqëri të bashkëpunimit bujqësor.

Dhe, ndërsa kemi një veprim, një ndjesi dhe reagim më pozitiv nga sektori privat, për arsye të thirrjes së qeverisë për të kooperuar dhe krijuar shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, deri tani janë përgjigjur vetëm 104 subjekte të tilla, që janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Kjo thirrje nuk u mbështet nga institucionet e tjera të shtetit, nga tatimet dhe nga doganat.

Dhe mund të them sot se të gjitha këto shoqëri janë ndëshkuar me gjoba administrative, etj. Këto gjoba mund të eliminoeshin, nëse do të kishim një proces lehtësirash në procesin e konsolidimit të këtyre shoqërive.

Pra, nuk kemi periudhë lehtësish në këtë fazë. U ndëshkuan fiskalisht dhe ndëshkimi bëri që të frenohej veprimtaria e tyre. Pasoja ishte që, duke frenuar këtë veprimtari, për rrjedhojë nuk u krijuan shoqëri të tjera.

Dhe qëllimi i Skemës Kombëtare 2025 dhe i mbarë qeverisë ishte pikërisht që të rriteshin më herët shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor. Kjo nuk ndodhi.

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) ka propozuar që të falen gjokat e këtyre shoqërive, në shenjë besimi për kooperimin.

Pastaj t'u mundësohen kredi të buta këtyre shoqërive-filiza, për të rimarrë veten. E kemi domosdoshmëri që të kualifikohen stafet drejtuese të tyre.

Sepse është e domosdoshme që Universiteti Bujqësor, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Arsimit, të hartojnë një kurrikul të posaçme për kualifikimin e stafeve të këtyre shoqërive. Kjo, ngaqë pa kualifikimet e stafeve nuk bëhet si duhet ky proces.

Të gjitha grupimet e tjera, forma të reja që kanë të bëjnë me shërbimin ndaj fermerëve,

duhet po ashtu të mbështeten.

Krijimi i këtyre grupimeve është emergjencë që Shqipëria duhet ta marrë në konsideratë, që pastaj të vijojmë me mekanizimin dhe digjitalizimin e procesit.

Pa bazën e këtyre shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, do të kemi shumë pak veprime inovative, në mënyrë që ky proces i kooperimit të japë rezultatet e veta. Këto janë disa nga arsyet që këto shoqëri nuk kanë ecur si duhet.

CMG: Fondet nga Buxheti i Shtetit për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural për vitin 2026 janë rritur. Por a mos duhej të ishin shumë më tepër? Çfarë mund të bëhet që fondet për bujqësinë të shtohen akoma, sidomos në mes të vitit, në korrik 2026, kur mund të rishikohet buxheti?

Agim Rrapaj: Do ta shikojmë në dy këndvështrime. Po ta shikojmë në këndvështrimin e ecurisë dhe programit të Skemës Kombëtare të Mbështetjes, fondet për bujqësinë kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit me 10–12 përqind.

Po ta shikosh në këndvështrimin e shtimit, në krahasim me vendet e rajonit, jemi ende shumë prapa. Në nivel të përqindjes që zë bujqësia në Shqipëri në GDP-në e saj dhe në ekonominë e ushqimit në tërësi, ndaj totalit të Buxhetit të Shtetit, shohim që rajoni i ka mesatarisht 3.5–5 përqind pjesë të shpenzimeve buxhetore, që i

bërë si Këshilli i Agrobiznesit, na rezultojnë që bujqësia kërkon edhe 90 milionë euro të tjera financime shtesë për këtë vit, dhe jo 10–12 milionë euro sa janë dhënë, në mënyrë që të kapë minimumin e nevojshëm për t'u shërbyer këtyre sektorëve.

CMG: Si u mbyll viti 2025 me eksportet bujqësore? Si parashikoni ato për këtë vit?

Agim Rrapaj: Për të thënë të vërtetën, eksportet kanë ecur normalisht.

Kanë ecur gjithmonë në rritje, si në sasi edhe në vlerë. Dhe kjo, falë investimeve që janë bërë në mjediset e mbrojtura për bujqësinë, veçanërisht në serra.

Kemi parasysh se kemi mbi 2 200 ha sera. Kjo përfaqëson një dyfishim të sipërfaqes në harkun e 5 viteve të fundit. Nga ana tjetër, kjo bën që ne të garantojmë eksportin e produkteve bujqësore.

Por ka edhe një moment tjetër që duhet theksuar. Mendoj se është bërë një punë shumë e mirë, përsa i përket cilësisë, standardeve të saj dhe sigurisë së konsumatorit.

Dhe në këtë drejtim janë disa projekte të OKB-së, siç është projekti UNIDO, me programin global "Për cilësi dhe standarde", që po i japin Shqipërisë një ndihmesë të jashtëzakonshme për të konsoliduar këtë proces.

Eksportet janë të lidhura ngushtësisht me cilësinë. Kjo është e lidhur me tregjet ku ne eksportojmë, që janë kryesisht tregjet e Bashkimit Evropian. Dhe tregjet e BE-së janë tregje që blejnë me çmime më të larta. Janë tregje që kërkojnë cilësi dhe standarde.



planifikon për këta sektorë (bujqësinë dhe zhvillimin rural).

Tek ne, Shqipëria shkon deri në 1.5 përqind në planifikimin e shpenzimeve. Pra, kemi dy herë më pak shpenzime. Kjo do të thotë që ne e mbështesim dy herë më pak sektorin privat dhe mjaft punë të tjera të sektorit publik, që i shërbejnë konsolidimit të këtij sektori.

Pra, krahasuar me rajonin jemi shumë më pak. Me Bashkimin Evropian jemi akoma edhe më pak.

Nga një sondazh që kemi

Këto janë arsyet pse eksportet kanë ecur mirë dhe objektivi është vendosur nga qeveria që, për vitin 2030, Shqipëria të arrijë të eksportojë 1 miliard euro eksporte bujqësore.

Gjykoj se eksportet bujqësore do të rriten edhe këtë vit dhe ky objektivi mund të realizohet. Por kjo do të ndodhë nëse do të riparojmë këto defekte që përmendëm më sipër, në mënyrë të tillë që ky proces të ecë pa u ndalur dhe të arrihen rezultatet e duhura.

POLITIKA FISKALE

Ibrahimaj: Banka Kombëtare e Zhvillimit, financim zhvillimit në pushtetin lokal

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj deklaroi se mbledhja e të ardhurave dhe taksave nga bash-

të. Kemi folur për sh.a-të e përbashkëta mes bashkive dhe sektorit privat. Kemi folur për mundësinë që disa prej jush të

aseteve, me QTTB (Qendrat e Transferimit Teknologjik Bujqësor) dhe bizneset si pronarë të dijës menaxheriale dhe praktike”, vijoi ajo.

“Në fushën bujqësore ka një potencial shumë të lartë dhe për disa bashki do ndërtojmë një projekt pilot që të ndërtojmë një plan biznesi që do të ketë nevojë për financime. Ne po operacionalizojmë Bankën Kombëtare të Zhvillimit, e cila qëllimin kryesor ka pasur financimin e zhvillimit në pushtetin lokal, ku financimi është më i ulët. Duke pasur një plan të qartë në pesë bashki pilot, do të bëjmë që brenda këtij viti të financojmë këto projekte pilote”, tha Ibrahimaj.

Ibrahimaj theksoi se ka një instrument financues që është në dispozicion të biznesit, por edhe shoqërvie ku pjesëmarrës është edhe shteti, dhe kjo është Banka e Shqipërisë që sipas ministres së Ekonomisë dhe Inovacionit, ka vendosur në dispozicion një fond prej 250 milionë eurosh me qëllim financimin e biznesit me kosto të ulët.

“Qeveria ka venë në dispozicion një garanci sovranë e cila mbulon pjesën më të madhe të riskut që të mos vendoset një kolateral i madh. Duhet të përqendrohemi të gjenerimi i të ardhurave pasi jo çdo gjë varet nga Buxheti i Shtetit. E rëndësishme është që të gjejmë instrumenta se si këtë rritje ekonomike ta mbajmë me po të njëjtat ritme”, pohoi Ibrahimaj.



kitë është vetëm një element në gjenerimin e të ardhurave.

Në takimin ku të pranishëm ishin edhe Kryeministri Edi Rama, ministri i Pushtetit Vendor Ervin Demo, ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja dhe kryetarët e bashkive në vend, Ibrahimaj tha se të ardhurat nga turizmi në bashkitë në vend duhet të rritur me 6.6% njësoj siç është rritur numri i turistëve me 6.6%. Por, kjo sipas Ibrahimajt ka ndodhur vetëm në ato bashki ku fokusi ka qenë më i madh në mbledhjen e taksave dhe të ardhurave.

“Taksat dhe tarifat janë një element. Paketa e Maleve është një mundësi e jashtëzakonshme për të nxitur zhvillimin e investimeve në bashkitë që mbuloni. Një tjetër formë se si mund të krijohen të ardhurat janë sha.a-

krijonit ndërmarrje për të menaxhuar tregjet apo pika grumbullimi”, tha ajo.

Ministria Ibrahimaj shtoi se 10 bashki janë financuar nga AZHBR për të ngritur tregjet, që edhe kjo është një formë që gjeneron të ardhura duke i dhënë akses të gjithë prodhimit bujqësor apo blegtoral që ndodhet në sipërfaqet që bashkitë mbulojnë.

“Një tjetër formë është një bashkëpunim trepalësh. Bashkitë kanë asete që duhet t'i venë në dispozicion. Në disa bashki janë qendrat e transformimit bujqësor, të cilat kanë njohurinë dhe ka subjekte private që kanë dëshirën për të gjeneruar të ardhura dhe aftësinë menaxheriale. Është shumë e vlefshme që të ketë një bashkëpunim që të krijohen shoqëri të përbashkëta me këto komponentë, me bashkinë si pronar i

Startup-et do të përfitojnë mbështetje financiare dhe shërbime mbështetëse për zhvillimin e bizneseve të tyre

Startup-et do të përfitojnë mbështetje financiare dhe shërbime mbështetëse për zhvillimin e bizneseve të tyre.

Kjo mbështetje mund të vijë në formë të ndryshme, duke përfshirë grante, financime me kapital, mbulim kostosh për kërkimin dhe zhvillimin e projekteve, si dhe shërbime teknike si konsulencë ligjore, financiare, ose për zhvillimin e biznesit. Për më tepër, startup-et mund të kenë akses në infrastrukturën e kërkimit dhe mundësi për testim të produkteve ose teknologjive të reja.

Në Fletoren Zyrtare u publikua vendimi për miratimin e thirrjes për aplikime, kërkesave, kriterëve, procedurave dhe afateve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e tyre për financime dhe/ose masa mbështetëse, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe të shpërblyerjes së anëtarëve

Për të përfutur nga këto mundësi, startup-et duhet të jenë të regjistruara në regjistrin elektronik të startup-eve dhe të përbushin disa kushte të tjera, si përm-

Përveç mbështetjes financiare, startup-et do të kenë mundësinë të bashkëpunojnë me lehtësuesit e tyre, të cilët mund të ofrojnë mbështetje



bushja e detyrimeve tatimore.

Procesi i aplikimit është i thjeshtë dhe kryhet përmes platformës digjitale “e-Albania”, ku startup-et duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, duke specifikuar fazën e zhvillimit të tyre (fillestare, validim ose rritje).

teknike dhe shërbime të tjera që do të ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të biznesit të tyre.

Agjencia për Zhvillimin e Startup-eve dhe Inovacionit do të monitorojë projektet dhe do të sigurojë që ato të përbushin objektivat e përcaktuara.

Klosi: Komisioni për Bujqësinë, platformë për politikën e sektorit

Kryetari i Komisionit për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural, Blendi Klosi



u shpreh se krijimi i komisioneve të reja është një hapësirë më shumë sa i përket situatës në raport me ligjet thelbësore

dhe politikën që zhvillohen në Parlamentin e Shqipërisë.

Në fjalën e tij, gjatë takimit të grupit parlamentar të PS, Klosi u shpreh se komisioni duke qenë i ri ka kaluar në një vendim për ndarjen në tre nënkomisione për infrastrukturën dhe zhvillimin rural, për ushqimin dhe për mbështetjen financiare të bujqësisë.

“Kemi pasur pak më pak veprimtari se komisionet e tjera, 11 mbledhje të komisionit, 4 dëgjesa publike me grupet e interesit dhe shoqërinë civile, 2 dëgjesa me ministrin. Komisioni është për t'u vlerësuar edhe nga pikëpamja e rakordimit me kabinetin e ministrit përkatës të bujqësisë duke krijuar një raport shumë pozitiv me institucionin që mbulon komisionin

tonë”, tha ai.

Klosi kërkoi që duke qenë një komision i ri dhe i fokusuar në një sektor të caktuar të merret ngarkesë edhe nga komisione të tjera që nuk kanë lidhje me bujqësinë, për të plotësuar më mirë hapësirat që ka Kuvendi.

“Është një komision që ka një hapësirë shumë të madhe për të diskutuar dhe për t'u shndërruar në një platformë për politikën sa i takon bujqësisë”, pohoi Klosi.

Klosi u ndal te fokusi i punës në nisje të sesionit të ri parlamentar, siç janë sipas tij ligjet që vijnë nga procesi i integritetit, monitorimi në terren i fushës së përgjegjësisë së komisionit, mbikëqyrjen e fondeve publike në mbështetje të bujqësisë, etj.

“Edhe njëherë që dua ta lavdëroj nuk është në sallë”, Braçe “zbut” tonet me ministrin e Bujqësisë: Më vjen mirë që fondi është realizuar 100%

Deputeti socialist, Erion Braçe foli në Kuvend për aktin normativ për rishpërndarjen e buxhetit 2025. Braçe tha se ku akt normativ meriton lëvdim sa i takon shpërblimit të dhënë

tin e disatë me rënie dhe sektori tjetër që është sektori jetik që ka të bëjë me industrinë që shënon rënie. Ka të meta që kërcasin në këtë akt normativ. Akti meriton lëvdim sa i takon shpërblimit



për shtresat në nevojë veçanërisht ata me ndihmë ekonomike dhe aftësi ndryshe.

“Ekonomia vazhdon të zgjerohet dhe viti 2025 shënon zgjerim të rëndësishëm 3.5%, 3.9% pret ministri, ndërkohë që inflacioni mbetet në nivele të ulëta, ndërkohë që eksportet vazhdojnë të rriten. Rezerva e vetme që unë kam është bujqësia që vazhdon të numërojë vi-

të dhënë për shtresat në nevojë veçanërisht ata me ndihmë ekonomike dhe aftësi ndryshe. Nëse për realizimin e të ardhurave është evidente fakti që po mblidhen më shumë të ardhura, në krahun e shpenzime publike vazhdojmë të kemi mosrealizime”, tha Braçe.

Braçe u ndal edhe tek sektori i bujqësisë, kur tha se edhe njëherë që donte të lavdëronte

ministrin e Bujqësisë Andis Salla, ai nuk ishte në sallë. Braçe tha se i vjen mirë që janë shtyar paratë nëbujqësi, ndërsa kërkoi dëmshpërblim për dëmet nga përmbytjet.

“Edhe njëherë që dua ta lavdëroj ministri i bujqësisë nuk është. Më vjen mirë që paratë janë shtuar në bujqësi, fondi është realizuar 100%. Nga thesari ka shkuar në bankë, janë pagesa që nga banka duhet të shkojnë në xhepat e qytetarëve, por ama ajo që më shqetëson ka të bëjë me faktin që kanë ndodhur fatkeqësi të mëdha natyrore dhe bujqësia ka marrë goditje të konsiderueshme. Goditje për bujqësinë erdhi në verë në dy zona të rënd, Gramshi dhe Delvina, dhe duhet të paguajmë për to. Përmbytjet e kombinuara me ngrica nëntor dhe janar kanë goditur Shkodrën, Obotin për të vazhduar në Zadrinë Durrës”, tha Braçe.

Përgjigje mori nga Taulant Balla i cili tha se grupet e qeverisë dhe pushtetit vendor janë në terren për evidentimin e dëmeve.


Malaj: Bujqësia sektor prioritar, subvencione direkte fermerëve dhe rimbursim të TVSH-së

Ministri i Financave, Petrit Malaj deklaroi se në muajin shtator do të nisë projekti IPARD 3 ku janë edhe 118 milionë euro të tjera për sektorin e bujqësisë.

Në fjalën e tij në takimin me fermerët në Divjakë për Skemën Kombëtare 2026, ku është i pranishëm edhe kryeministri Edi Rama, Malaj tha se bujqësia konsiderohet nga Qeveria si sektor prioritar. “Shifrat tregojnë realitetin dhe seriozitetin që ka kjo qeveri në lidhje me sektorin e bujqësisë. Në vitin 2013 kur morëm drejtimin e këtij vendi

kemi marrë një bujqësi me buxhet 34 milionë euro, e kemi mbyllur 2025 me një buxhet 162 milionë euro, pesëfishi i asaj që morëm. Kemi marrë një bujqësi, e cila i kishte eksportet rreth 120 milionë euro, e cila sot në terma eksporti është mbi 500 milionë euro”, theksoi Malaj. Malaj vuri në dukje se “kemi marrë një bujqësi që kishte në sipërfaqe ser-rash 700 ha ndërsa sot janë trefishuar sipërfaqet e serrave mbi 2200 ha. Kemi marrë një bujqësi ku toka e ujitur ishte 120 mijë ha dhe këtë vit do shkojmë në

300 mijë ha nga 360 mijë ha që është sipërfaqja e tokës së ujit në terror”. Në këtë mandat, vijoi Malaj, qeveria është e angazhuar që të ndërtojë një model, i cili synon të mbështesë drejtpërdrejt fermerët. “Ky është një model që është i ngritur në 4 komponentë kryesorë. Ai renditi skemën e granteve ku për 2026 janë parashikuar 20 milionë euro, skemën e subvencioneve direkte për fermerët që është 31 milionë euro e buxhetuar për 2026 si dhe garancinë sovranë dhe rimbursimin e TVSH-së.



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



SHOQATA BLETARËVE

Bletët bashkojnë Skandinavinë

- Apimondia 2025: 23-31 shtator 2025 -

“Bletët bashkojnë Skandinavinë” - Kjo ishte motoja e Kongresit të 49-të të Federatës Botërore të Bletarëve, Apimondia 2025. Në të vërtetë ky kongres jo vetëm bashkoi vendet skandinave, Danimarkën, Suedinë e Norvegjinë në organizimin e tij, sidomos në turet e përbashkëta turistike mbi bletarinë, por njëherazi bashkoi bletarët e gjithë rruzullit tonë për të diskutuar për bletarinë, problematikat dhe bashkëveprimet në mbrojtje të bletëve.

Në të dhënat e mëposhtme kuptohet më mirë bashkëveprimi i bletarëve pa kufi, ashtu siç edhe bletët “nuk duan t’ia dinë për kufinj”:

- Në kongres morën pjesë mbi 8000 bletarë nga 124 vende të të gjitha kontinenteve;

- U mbajtën shumë simpoziume, ku referuan mbi 300 studjues e bletarë profesionist;

- U ekspozuan, sipas problematikave, mbi 600 postera;

- U ekspozuan në Api-Expo 177 kompani bletarie;

- Konkuruan me prodhime bletarie, materiale e botime për bletarinë me qindra vetë, etj.

I kisha rënë rrotull Rruzullit Tokësor nga Australia, Singapuri, Kina, Kanadaja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shumë vende të tjera europiane, kryesisht për bletarinë, por në vendet skandinave nuk kisha qenë asnjëherë. Me Danimarkën më lidhte Shekspiri me Hamletin, një tragjedi e famshme e lexuar dhe e parë në teatër e kinema disa herë. “Të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja”, që vazhdon me shekuj të tundojë njerëzit anë e mbanë globit se cilën mëdysheje të ndjekësh.

riudhës 1996-1997, si një nga vullnetarët e Korpusit të Paqes, i ardhur nga Amerika, por me prindër nga Danimarka, dhe Asgard Sogaard Jorgensen, i cili me ftesën time bëri një vizitë 4 ditore në Shqipëri në vitin 2007, kohë kur unë drejtoja Shoqatën e Bletarëve të Shqipërisë.

Jorgensenin e takova në mjediset e “Bella Center”, ku u mbajt kongresi, biseduam së bashku dhe ai i kujtoi me nostalgji ato ditë në Shqipëri. Megjithëse kishte qenë shumë vite president i Apimondias, ai çdo ditë ndihmonte në mbarëvajtjen e punëve, së bashku me mbi 100 vullnetarë të tjerë.

A mund ta mendoni një zyrtar aq të lartë shqiptar të veshë bluzën e vullnetarit dhe të përvesh mangët për një javë rresht?

Gjatë 5 ditëve të kongresit mora pjesë në disa simpoziume si ata për Shëndetin e Bletëve, Apiterapinë, Biologjinë e Bletëve, etj., si dhe u njoha me shumë punime studimore të paraqitura me postera. Në standin e Apimondias pata takime të shkurtëra me Presidentin z. JeffPettis, Sekretarin e Përgjithshëm, z. Rikardo Jannoni-Sebastianini, me të cilët isha takuar edhe në aktivitete të mëparshme. Gjithashtu patëm një bisedë me Presidentin e Komisionit të Europës z. Robert Clilebo si dhe shumë drejtues shoqata bletarësh, studjues e drejtues kompanishë etj.

programin e çdo dite dhe unë qarkoja në darkë ato simpoziume e tema që më interesonin më shumë. Disa holle të mëdha krijonin mundësi çlodhjeje, biseda të lira, kafe, punime në kompjutera, takime etj.

Në “Bella Center” kishin mjediset e tyre 177 kompanitë më të njohura të bletarisë në botë. Çdo ditë më mijëra njerëz vizitonin standet, njiheshin me prodhimet e shumë prej tyre uleshin në bisedime për bashkëpunim. Të njëjtën gjë, sigurisht që e bëra edhe unë.

Presidenti i Apimondias në përshëndetjen e tij cilësonte se Api-Expo krijon mundësinë për gjithsecilin të njihet me të rejtat më të fundit në çdo fushë të bletarisë. Të gjithë, e pranojmë se “Bella Center” me Api-Expon e saj ishte më e kompletuara, me një stad më të lartë cilësor të produkteve, me një paraqitje mbresëlënëse dhe me finalizime marrëveshesh të reja nga shumë kompani. Për 5 ditë me radhë, “Bella Center” u kthyenë një “zgjuar bletësh” ku secili, ashtu si tek bletët, bënte punën e tij në harmoni të plotë me bashkësinë.

Kopenhagen është kryeqyteti i Danimarkës me rreth 1.300.000 banorë. Ai njëherazi është edhe porti kryesor. Vetë kuptimi i emrit Kopenhagen do të thotë: “Port tregtarësh”. Mu në qendër të qytetit, nën tokë, është stacioni qendror i trenit dhe i dy metrove nga vijnë e largohen shumica e banorëve dhe turistëve. Të tri vendet skandinave përdorin monedhat e tyre. Me një biletë rreth

1615 ajo ishte përmbi 100 vite rezidenca mbretërore, gjersa mbreti Frederiku i VI-të e ktheu në muze dhe për vete ndërtoi kështjellën që mban emrin e tij., “Frederiksborg”.

Pas vizitës së kështjellës vazhduam me parkun e madh dhe shumë të bukur përballë saj. Një numër i madh turistësh i sillëshin rrotull kësaj kështjelle katërqind vjeçare, duke e fotografuar e kundruar të mahnitur nga bukuria e saj dhe mjediset për rreth. Kopenhagen më la mbresa të pashlyera. Po përcjell tre prej tyre:

Përdorimi i biçikletave:

Nuk kisha parë ndonjë qytet tjetër në Europë të përdornin aq masivisht biçikletën. Në çdo institucion, qendër pune, hotele e shkolla, stacione metroje etj, gjeje të parkuara biçikleta të panumërta. Edhe në qendër të Kopenhagenit parkingu i biçikletave ishte më i madhi. Nga statistikatat shkruhej se mbi 35% e njerzve shkonin në punë, shkollë apo ku kishin dëshirë, me biçikleta. Rugët kishin korsi të veçanta për biçikleta dhe sinjalistikë të posaçme. Përdorimi masiv i biçikletave, rrugët e posaçme e parkingjet për to, pakësonin trafikun e makinave, ulnin stresin e parkimeve, pakësonin ndotjen, kursenin kohën, ulnin shpenzimet etj. Fotoja e vendparkimit të biçikletave në qendër të Kopenhagenit, flet më tepër se këto fjalë që po shkruaj unë.

Mendoj që institucionet tona shtetërore e studiot e arkitektëve duhet të bëjnë gjënë e

kartën e kreditit që ngrohte kot portofolin tim prej disa vitesh. Në Danimarkë pothuajse çdo shërbim merrej e paguhej me kartën e kreditit. Asgjë s’mund të bëje pa të.

Duke qenë se në Shqipëri përdorej fare pak, pothuajse kisha harruar se si përdorej. Mirëpo, pas ditës së parë, mu duk zgjidhja më fantastike. Me të s’kishte nevojë për kusure, exchange, portofol për pagesat e çdo gjëje, për pagesat e transportit, tureve turistike, vizitave, shfaqjeve etj. Për 3-4 sekonda kryejë punë. Gjithë infrastruktura e blerjeve dhe shërbimeve kishte në qendër kartën e kreditit.

Zhurmat:


Në dy kryeqytete që qëndrova, në Kopenhagen dhe Oslo, nuk dëgjova zhurma nga muzika, apo televizori, bori makinash, apo karvane të zhurmshme dasmorësh. Mund të ishin dhjetëra vetë në kafene apo restorante dhe asnjë televizor nuk ishte i hapur, ndërsa tek ne mezi dëgjon shokun shokun me të cilin po pi një kafe nga ekranet e mëdha e me zë të lartë të vendosur në çdo anë. Kur doja të pija një kafe të vërtetë shkoje te “Espresso House” ku gjeje kafe të mirë, shërbyer në kënde të rehatshme e ku mund të rrije sa të doje, të shkruaje, të lexoj apo të bisedojë. Tek ne në kafe ka me dhjetëra tavolina, ku shumicën e kohës, 80% e tyre janë bosh e mezi mund të gesh një kënd për të biseduar i qetë.

zgjedha turin turistik dy ditore në Norvegji, në Oslo, me objektiv bletarinë urbane dhe mbështetjen e saj.

Shumë tërheqëse ishte rruga e gjatë me tragete 12 katëshe vajtje-ardhje, kryesisht natën. Ishim 37 bletarë nga vende të ndryshme në një grup, të prirë nga Aleksandri nje bletar profesionist me mbi 400 familje bletësh. Ai ishte njëherazi edhe Zëvendëskryetar i Shoqatës së Bletarëve të Norvegjisë. Në traget kishim dhoma vetjake secili, kushte shumë të rehatshme dhe ushqim të mirë, sipas dëshirës. Në çdo kat kishte grupe të vogla muzikore. Dy ditë sëbashku, patëm mundësi të njiheshim më gjithsecilin.

Në Oslo vizituam një qendër për bletarinë urbane të vendosur në rrethinat e saj, dhe të dhuruar për përdorim nga familja mbretërore. Qendër jepte përvojë për bletarët e Oslos, organizonte trajnime dhe praktika për bletarët qytetas, si dhe jepte mbështetje sipas projekteve dhe mundësive për ta. Patëm një ligjëratë nga drejtuesja e qendrës, bashkëbisedime dhe vizita. Gjithashtu, qendra përgatiti edhe një drekë shumë të këndshme me prodhime të saj. Pas dreke, unë mora leje për njëvizitë në qendrën e Oslos, për t’u ribashkuar me grupin në portin e Oslos, që ishte 20 minuta larg qendrës. Shumë turistë që po vizitonin rezidencën mbretërore e parkun e madh e të bukur përreth saj, po e filmonin përmes aparateve celularë këtë ceremoni.

Pasi vizitave në qendrën e qytetit dhe në një librari, ku bleva dy libra me përralla



Nga fundi i mijëvjeçarit të parë e gjer më sot, 51 mbretër e kanë sunduar Danimarkën. Nga viti 1387 kur mbretëreshë u bë Margreta e I-rë e gjer më sot kur mbretëreshë është Margreta e II-të, kanë kaluar mbi 6 shekuj, por mbretëritë, megjithëse me funksione të pakësuar, akoma vazhdojnë të jenë, qoftë edhe simbolikisht përbashkuese e garantuese të sovranitetit.

Ditën e kthimit në Shqipëri, tek po ndiqja lajmet, pashë Margretën e II-të, të priste Kryeministrin Rama në Kopenhagen.

Me Danimarkën e sotme më lidhin më së shumti dy persona: Andy Jensen, i cili qëndroi në shtëpinë time gjatë pe-

Siç e përmenda edhe më lart, kongresi u mbajt në “Bella Center”. Si e ka emrin ashtu edhe ishte me të vërtetë kjo qendër. Me dhjetëra salla të madhësive të ndryshme ishin njëherazi në punë, të paisura me ekrane të mëdhenj, nga ku edhe i fundit në sallë i dukej se ishte në rreshtin e parë. Fonia, videot, ekranet, hapësirat, ajri i kondicionuar, ishin në nivelin më të mirë.

Në të gjithë simpoziumet që mora pjesë, kishte një korrektesë për fillimet, kohën e fjalës, pyetjet nga salla apo moderatorët, kohën e mbylljes etj. Gjithnjë simpoziumin e drejtonin dy moderatorë ekselent të asaj fushe që diskutohej. Një broshurë e madhe kishte

6 euro, mund të lëvizje 24 orë kudo brenda Kopenhagenit. Taksitë ishin të shtrenjta dhe shumica e shoferëve të tyre ishin me origjinë nga vendet aziatike. Vetë statistikatat e tyre jepnin shifrën që 17% të Kopenhagenit e përbënin emigrantët nga jashtë Bashkimit European.

Në tri gjysma ditësh vizitova qendrën e Kopenhagenit, Kështjellën Rosenborg, (kështjella rozë) bashkë me parkun e madh dhe shumë të bukur pranë saj. Një librari dhe një dyqan suvenieresh për kështjellën ishte fillisa orientuese e kësaj vizite. Një varg i gjatë vizitorësh pritnin radhën për t’u njohur me këtë kështjellë. E ndërtuar në vitin

duhur për të aplikuar masivisht përdorimin e biçikletave. Nëse Qeveria shqiptare e sheh të arësyeshme këtë përvojë, mund të bëj përshtatjet e rrugëve, sinjalistikës, vend parkimeve dhe çdo gjë tjetër që lidhet me të. Kopenhageni në Danimarkë, por edhe Shkodra jonë, bindin për rikthimin e biçikletave... Shkoni në Kopenhagen, në mos jo, shkoni në Shkodër...

Karta e kreditit: Para viteve 90-të të shekullit të kaluar, profesorët e filozofisë na përmendnin shpesh një thënie të Engelsit: Nevoja ka shtyrë përpara shoqërinë më shumë se dhjetëra universitete të marra së bashku. Nevoja më shtyu edhe mua të përdor

Nxitimet në ndërtim shtëpiash të mëdha, apo hapje biznesesh të ngjashme etj., pa studjuar perspektivën, apo pa marrë parasysh ligjet e ekonomisë së tregut, kanë bërë që të shkojnë dëm qindra miliona euro të fituara me djersë e gjak nga emigrantët.

Ture turizmi në bletari-Apiturizëm

Për hir të së vërtetës, të tri shtetet skandinave të marra së bashku kanë më pak bletë se sa ka Shqipëria. Ashtu si në Shqipëri, edhe në Norvegji, mbi 90% e bletarëve janë amatorë e hobistë. Gjatë kongresit dhe pas tij u organizuan shumë ture turistike bletarie në të tre shtetet. Unë

të Andersonit në gjuhën angleze, iu ribashkova grupit për kthim në Kopenhagen. Në kthim, kështjellën e Hamletit e pamë veçse nga trageti, në lëvizje.

Më duhet të theksoj se bletaria në Shqipëri është ndoshta e vetmja degë e bujqësisë që ka patur suksese e rritje, pavarësisht mbështetjes së paktë ndaj saj. Kjo i dedikohet punës dhe pasionit të bletarëve të shkëlqyer shqiptarë. Edhe turizmi në bletari po përparon, sidomos në Korçë, me firmën ekselente “Morava”, në Mirditë, Lezhë, Shkodër, Elbasan etj.

U ndamë me mallë me bletarët e grupit për t’u ritakuar pas dy vitesh në Dubai.

TURIZËM

Topuzi për ATSH: Pagesat elektronike në turizëm hap pozitiv, problem nivelet e larta të komisioneve bankare

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit, bizneset e sektorit të turizmit, si edhe subjekte të tjera të shërbimeve, do të jenë të detyruara që, përveç pagesave kesh (cash), të garantojnë edhe forma alternative të pagesave elektronike, përfshirë pagesat me karta krediti, karta debiti dhe mjete të tjera elektronike.

Kreu i Shoqatës së Operatorëve Turistikë, Zak Topuzi, në një prononcim për ATSH-në, e cilësoi këtë nismë të qeverisë si një hap pozitiv për vendin, duke theksuar se ajo ndikon drejtpërdrejt në formalizimin e ekonomisë dhe në përmirësimin e shërbimit ndaj turistëve.

“Plani ambicioz i Kryeministrit për ta shndërruar Shqipërinë në një vend me përdorim minimal të parasë kesh është interesant dhe i domosdoshëm. Është e sigurt që një nga sektorët kryesorë ku do të zbatohet kjo masë është turizmi dhe shërbimet”, u shpreh Topuzi.

Sipas tij, turizmi dhe transporti sigurojnë rreth 43,6% të totalit të eksporteve të vendit dhe përbëjnë një sektor strategjik për ekonominë shqiptare. Megjithatë, Topuzi vuri në dukje se industria e turizmit përballlet me disa problematika serioze që e kanë vështirësuar deri më tani zbatimin e plotë të pagesave elektronike.

“Dy elementë thelbësorë nuk janë trajtuar mjaftueshëm. Arsyeja kryesore është niveli shumë i lartë i komisioneve që aplikojnë bankat e nivelit të dytë për pagesat me karta. Ndërkohë që në Bashkimin Europian komisionet variojnë nga 0,3 deri në 0,6% në Shqipëri ato shkojnë nga 1,8 deri në 5%”, theksoi ai.

Topuzi nënvizoi se për bizneset e vogla të shërbimit, që operojnë me marzhe fitimi 7 deri në 10 për qind, këto komisione e penalizojnë ndjeshëm

aktivitetin. “Në këto kushte, banka kthehet në një aksionar kryesor, duke marrë deri në 30-40 për qind të të ardhurave të biznesit”, tha ai.

Një tjetër shqetësim i ngritur

Shqipëri, me rreth 12 milionë turistë të huaj në vit. Sistemi aktual nuk e lejon që bakshishi të kalojë përmes kartës, gjë që penalizon punonjësit e shërbimit”, theksoi Topuzi.



prej tij lidhet me faktin se komisionet për pagesat elektronike rëndojnë mbi subjektet dhe jo mbi klientët, ndërsa në transaksione të vogla kjo kosto bëhet e papërbalueshme. “Nuk është normale që për një pagesë të vogël, siç është një kafe, të paguhet komisione shtesë”, u shpreh Topuzi.

Ai e cilësoi proces për pagesave elektronike si një “revolucion të përgjithshëm”, që nuk lidhet vetëm me vendosjen e pajisjeve POS në njësitë e shërbimit, por kërkon ndërhyrje rregulatore nga Banka e Shqipërisë. “Banka Qendrore nuk duhet të jetë vetëm rekomanduese, por vendimmarrëse për kufizimin e komisioneve, ashtu siç kanë vepruar shumë vende europiane”, tha Topuzi, duke përmendur shembuj nga Greqia dhe Zvicra, ku komisionet janë ulur në nivele minimale.

Një tjetër çështje e rëndësishme, sipas tij, është mundësia e dhënies së bakshishit (tips) përmes kartës bankare. “Turizmi është kthyer në një nga industritë më të rëndësishme në

Ai bëri të ditur se Shoqata e Operatorëve Turistikë ka zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve dhe bankave për të mundësuar këtë proces, i cili është i aplikuar gjerësisht në vendet europiane dhe realizohet në mënyrë transparente përmes sistemit bankar dhe tatimor.

Ndër të tjera Topuzi gjithashtu theksoi rëndësinë e fushatave të informimit dhe trajnimeve për bizneset, veçanërisht për ato të vogla, si dhe zhvillimin e infrastrukturës teknike dhe teknologjike. “Është e vështirë që ky proces të realizohet plotësisht brenda gjashtë muajve pa mbështetje konkrete dhe pa uljen e komisioneve bankare”, tha ai.

Sipas tij, kjo masë do të ndikojë edhe në formalizimin e sektorit të akomodimit, ku aktualisht rreth 70 për qind e kapaciteteve janë apartamente dhe vila në formën B&B, ndërsa vetëm 22 për qind janë hotele. “Vendosja e pagesave elektronike do ta fusë këtë sektor në një regjim më të kontrolluar dhe më transparent”, përfundoi Topuzi.

Salla: Shqipëria mbështet angazhimin global për sigurinë ujore

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, mori pjesë në Konferencën e Minis-

ganzatave ndërkombëtare.

Konferenca u fokusua në dialogun agro-politik mbi temën



trave të Bujqësisë, të zhvilluar në kuadër të Forumit Global për Bujqësinë dhe Ushqimin (GFFA) 2026, me pjesëmarrjen e 61 ministrave të bujqësisë dhe 14 përfaqësuesve të lartë të or-

e këtij viti “Uji. Korrrjet. E ardhmja jonë.”, duke vënë theksin në rëndësinë e sigurisë ujore për garantimin e sigurisë ushqimore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

Gjatë punimeve të konferencës u miratua Komunikata Përfundimtare e GFFA 2026, e cila riafirmon mesazhin se pa ujë nuk ka ushqim dhe pa siguri ujore nuk mund të ketë siguri ushqimore.

Ministri Salla theksoi se Shqipëria mbështet plotësisht këtë angazhim dhe qasjen që e sheh bujqësinë si pjesë të zgjidhjes globale, përmes përdorimit të ujitjes inteligjente, zbatimit të praktikave që ruajnë tokën dhe burimet ujore, reduktimit të ndotjes dhe zhvillimit të bioekonomisë blu.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në GFFA 2026 vlerësohet si një mundësi për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.

Rama: Një mijë investime nga Paketa e Maleve, asnjë rikandidim nga kryebashkiakët nëse nuk arrihet targeti

Kryeministri Edi Rama u kërkoi kryetarëve të bashkive, të jenë proaktivë në zhvillimin e territorit dhe të mos mbështeten vetëm tek buxheti i shtetit.

Gjatë takimit të zhvilluar në Durrës, Rama theksoi rëndësinë e Paketës së Maleve, si një instrument që synon të tërheqë investime nga shqiptarët jashtë vendit. Rama shprehu shqetësimin se disa bashki nuk kanë përfunduar ende fazën e parë të këtij projekti.

Kryeministri vuri në dukje se jo të gjitha bashkitë e kanë kryer fazën e parë dhe kjo është e papranueshme.

“Në momenti kur Paketa e Maleve u shpall në uebsajtin e vet ditën e parë kishte 700 e kusur interesim nga shqiptarët jashtë atdheut. Është një instrument i sigurt për të tërhequr kursimet e shqiptarëve dhe atyre jashtë atdheut që të vijnë dhe të bëjnë biznes të sigurt që u sjell atyre të ardhura. Si ka mundësi që nuk ka mbaruar akoma faza e parë në të gjitha bashkitë?!”, tha Rama.

Ai vuri në dukje se ambicia e qeverisë duhet të jetë 1000 investime nga Paketa e Ma-

leve, ndërsa paralajmëroi se rikandidimi i kryebashkiakëve do të varet nga numri i investimeve në bashki.

nga kjo paketë që po t’i ndash në territor në 60 bashki sipas potencialeve nuk janë shumë. I kam kërkuar ministrit që të



“I kam kërkuar drejtores së Agjencisë së Planifikimit të jetë në dispozicion të së cilës bashki për asistencë teknike dhe i kam kërkuar ministrit Demo që të vendosë një target për çdo bashki. Ambicia jonë duhet të jetë 1000 investime

përcaktojë se sa investime duhet të jenë futur në proces ku secili prej jush do të pretendojë të rikandidojë. Nuk do të ketë asnjë rikandidim të mundshëm nëse nuk do të jetë arritur targeti i këtij projekti”, tha Rama.

Demo: Bashkitë, potenciale për të krijuar ekonomi lokale të qëndrueshme

Ministri i Shtetit për Pushetiv Vendor, Ervin Demo deklaroi, se bashkitë duhet të luajnë një rol aktiv në procesin e rritjes ekonomike në vend.

Demo ishte i pranishëm në takimin e thirrur nga Kryeministri Edi Rama me kryebash-

kë të rëndësishëm pasi energjia që çlirohet në nivel lokal është shumë e rëndësishme. Burimet e rritjes ekonomike janë ato ku bashkitë duhet të luajnë një rol proaktiv në këtë kontekst”, tha Demo, ndërsa theksoi se duhet një ndryshim rrënjësor për sa i

për situata emergjente, mbi të gjitha për t’i parandaluar ato dhe për të krijuar zhvillim territorial, sidomos kur flasim për logjistikë, për mirëmbajtje infrastrukturë rurale”, theksoi ai.

Ministri Demo u ndal edhe te Paketa e Maleve, Granti i Performancës, për rolin që ka Akademia e Pushtetit Vendor për Strategjinë Kombëtare të Turizmit, për rregulloren e plazheve dhe një përgatitje më të mirë, edhe një qasje më të lehtë të qytetarit në plazhet e jashtëzakonshme të vendit.

“Suksesi i Shqipërisë sa i përket turizmit në 12 muaj të vitit, është jo vetëm nga bregdeti. Të 61 bashkitë e vendit duhet të jenë të përgatitura. Kjo tregon potencialin e jashtëzakonshëm që kanë të gjitha bashkitë, për të krijuar ekonominë lokale të qëndrueshme. Pasi në çdo cep të territorit ne mund të kemi një aktivitet ekonomik”, tha Demo.

Demo shtoi se viti 2026 mbart shumë sfida për Shqipërië, edhe në aspektin e punës për procesin e integritetit, ndërsa tha se të gjitha bashkitë duhet të jenë të përgatitura për një “cunami” nga pikëpamja rregullative që bashkitë do kenë në jetën administrative dhe që këto të përkthehen në shërbime në territor për qytetarët.



kiakët, ku u diskutuan sfidat e bashkive për vitin 2026, sezoni turistik dhe betejat e përbashkëta politike e shoqërore kundër mbetjeve plastike.

Ministri Demo, gjatë fjalës së tij tha se qasja e qeverisë është qasje e një partneriteti të sigurt me autoritetet lokale.

“Shqipëria ka një potencial të jashtëzakonshëm për të kërcyer lartësi të cilat do të krijojnë një transformim rrënjësor jo vetëm ekonomik, por edhe social. Në këtë kuadër, bashkitë kanë një rol shumë

përket asaj që ndodh në territor dhe rritjes ekonomike në nivel vendor.

“Sfidat me të cilat bashkitë përballen janë dinamike, diverse për shkak të arsyeve që mund të vijnë nga elemente që janë të paparashikueshëm siç janë edhe përmbytjet e ditëve të fundit, por besoj që ne të gjithë duhet të bëjmë shumë për parandalimin e këtyre situatave. Ndihami që këto bashki do të marrin nga qeverisja qendrore do të bëjë të mundur që jo thjesht të jemi të përgatitur

Buka, ku mbështetet Shqipëria? Analiza: Si ka ndryshuar gjeografia e furnizimit me drithëra të vendit

Importet e drithërave të Shqipërisë kanë kaluar një transformim të dukshëm gjatë dekadës së fundit, duke

pavarësisht se Rusia mbeti një furnizues i rëndësishëm, peshën e saj e gërryen kufizimet tregtare, pasiguritë



reflektuar jo vetëm zhvillimet ekonomike, por edhe goditjet gjeopolitike që kanë tronditur tregjet globale të ushqimit. Të dhënat tregojnë se, ndonëse vlera totale e importeve ka mbetur relativisht e lartë ndër vite, pesha e vendeve furnizuese ka ndryshuar ndjeshëm, veçanërisht pas vitit 2022.

Në vitin 2015, tregu shqiptar i drithërave karakterizohej nga një varësi e fortë nga Rusia, e cila mbulonte rreth 42% të totalit të importeve. Serbia renditej e dyta me rreth 27%, ndërsa pjesa tjetër ndahej mes Italisë, Spanjës, Greqisë dhe disa partnerëve të tjerë me peshë më të kufizuar.

Situata filloi të ndryshojë gradualisht pas vitit 2020, por thyerja kryesore ndodhi pas shpërthimit të luftës në Ukrainë. Në vitin 2022,

logjistike dhe rritja e kostove, duke bërë që ajo të humbasë rolin dominues që kishte prej vitesh. Në vitin 2023, Rusia zbriti në rreth 22% të totalit, duke u kaluar për herë të parë nga Serbia.

Ndërkohë, Serbia u konsolidua si partneri kryesor i Shqipërisë për importin e drithërave, duke arritur një peshë prej 36.5% në vitet 2023.

Një tjetër ndryshim domethënës ishte rritja e përkohshme e importeve nga Ukraina. Nga një peshë pothuajse e papërfillshme para vitit 2020, Ukraina arriti deri në 13.5% të totalit në vitin 2023, duke reflektuar përpjekjet e tregjeve europiane për të mbajtur funksionalë korridoret e eksportit të drithërave gjatë luftës. Megjithatë, kjo peshë u tkurr sërisht në vitin

2025.

Paralelisht me këto zhvillime, vërehet edhe një diversifikim i kujdesshëm i burimeve të furnizimit. Vende si Italia, Greqia dhe Spanja ruajtën një prani të qëndrueshme, ndërsa pas vitit 2022 u rritën importet nga Kanadaja, Kina dhe Maqedonia e Veriut.

Në vitin 2025, importet e drithërave të Shqipërisë dominohen qartë nga Serbia, e cila mban 36.5% të peshës totale, duke u konfirmuar si partneri kryesor i furnizimit. Rusia renditet e dyta me 29.6%, duke ruajtur një rol të rëndësishëm, por pa arritur pozitat dominuese të viteve para luftës në Ukrainë. Pas tyre, pesha e importeve shpërndahet në mënyrë më të fragmentuar, ku Italia mbulon 5.2%, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 4.2%. Ukraina mban 2.7%, ndërsa Kroacia, Kina dhe Kanadaja kontribuojnë secila me rreth 2.4%.

Në aspektin e bilancit tregtar, të dhënat tregojnë se Shqipëria mbetet një importues neto i drithërave. Eksportet janë shumë herë më të ulëta se importet dhe shënojnë luhatje të forta ndër vite, me një rritje të pazakontë në vitin 2022, e ndjekur nga rënie sërisht në vitet pasuese. Kjo thekson edhe më shumë ndjeshmërinë e vendit ndaj lëkundjeve të tregjeve ndërkombëtare të ushqimit, sidomos me dërgesa drejt Kosovës.

Për të ruajtur traditën, artizanët e Gjirokastrës të shqetësuar për mungesën e interesit të të rinjve

Artizanati përbën një nga shtyllat kryesore të identitetit kulturor të qytetit të Gjirokastrës, i lidhur ngushtë me historinë dhe traditat e tij shekullore.

Punimet artizanale, të trashëguara brez pas brezi, janë pjesë e pandashme e karakterit të qytetit dhe një vlerë që kërkon mbrojtje dhe ruajtje të vazhdueshme.

Artizanët e zonës së pazarit karakteristk kërkojnë më shumë mbështetje dhe fuqizim të këtyre zanateve, përmes nismave konkrete që ndihmojnë në promovimin dhe zhvillimin e tyre.

“Do ishte mirë që të bëheshin trajnime apo kurse të ndryshme në mënyrë që të trajnohej edhe brezi i ri”, u shpreh një artizan.

Në të njëjtën kohë, artizanët u bëjnë thirrje të rinjve që

të mësojnë këto zanate dhe të mos lejojnë që ato të mbeten në harresë.

“Kam 40 vite në këtë profe-

artizani.

Sipas tyre, artizanati nuk është vetëm trashëgimi kulturore, por edhe një mundësi



sion dhe kanë qenë shumë të rralla rastet e interesimit për të mësuar këtë profesion”, tha

punësimi dhe zhvillimi ekonomik, që mund t’i japë jetë të re qytetit të Gjirokastrës.

Importet e ushqimeve rriten me 23% në pesë vite; importohet më lirë, shitet më shtrenjtë

Vit pas viti vendi ynë është duke rritur varësinë nga ushqimet e importit si rrjedhojë e

lutë për ushqime të importuara, çdo kilogram ushqim importi po kushton më pak vit pas viti.



uljes së prodhimit vendas dhe nevojave më të larta për konsum nga turistët.

Në vitin 2025 u importuan 1,347,550 tonë ushqime, me rritje vjetore 4.3% sipas të dhënave zyrtare të INSTAT. Vlera e importeve shënoi gjithashtu rritje me 3.9%.

Të dhënat tregojnë se nga njëra anë sasia e ushqimeve të importuara po rritet me ritme të qëndrueshme, ndërsa çmimi mesatar për kilogram i importeve po bie, duke e bërë ushqimin e importuar gjithnjë e më të lirë. Kjo nuk duket se është reflektuar në tregun e pakicës, ku çmimet si të ushqimeve, ashtu dhe të rafteve në supermarketet vetëm sa po shtrenjtohen.

Në vitin 2020, Shqipëria importonte rreth 1.09 milionë tonë ushqime dhe pije. Në vitin 2025, kjo sasi arriti në 1.35 milionë tonë, një zgjerim prej mbi 250 mijë tonësh ose rreth 23% më shumë brenda pesë vitesh. Vitet e fundit, konsumi i brendshëm po mbështetet gjithnjë e më shumë te tregjet e jashtme për të mbuluar nevojat bazë ushqimore, në një kohë kur kërkesa është rritur edhe nga turizmi.

Në të njëjtën kohë, vlera totale e importeve në lekë është rritur, por jo në të njëjtin ritëm me sasinë. Nga rreth 110.9 miliardë lekë në vitin 2020, importet arrijnë në mbi 162 miliardë lekë në vitin 2025. Ndonëse Shqipëria po shpenzon më shumë në terma abso-

çmimi mesatar për kilogram, i cili arriti kulmin në vitin 2022, në rreth 146 lekë për kg gjatë krizës globale të çmimeve pas luftës në Ukrainë, ka rënë gradualisht deri në rreth 120 lekë për kg në vitin 2025, një ulje prej afro 18% në vetëm tre vjet. Kursi i këmbimit ka favorizuar dukshëm importuesit, teksa euro u këmbye mesatarisht me 97 lekë në 2025-n, nga rreth 140 lekë që ishte në 2015-n.



Shqipëria sot po blen ushqime më lirë në tregjet ndërkombëtare sesa gjatë periudhës së pikut të krizës, por po blen shumë më tepër. Rënia e

çmimit për njësi ka ndihmuar që faturat e importeve të mos rriten aq sa sugjeron rritja e fortë e sasive, duke amortizuar presionin mbi çmimet e brendshme. Kjo prirej tregor edhe një varësi gjithnjë e në rritje nga furnizimi i jashtëm për ushqimet bazë, duke e bërë ekonominë më të ndjeshme ndaj luhatjeve të tregjeve ndërkombëtare në të ardhmen.

Një pjesë e rritjes së volumit të importeve po vjen nga vende si Turqia, Ballkani, Amerika Latine dhe tregje të tjera ku prodhimi bujqësor është më i lirë sesa në BE.

Rritja e turizmit dhe e konsumit urban ka shtuar kërkesën për produkte të standardizuara, të paketimit industrial dhe të prodhuara në seri të mëdha, të cilat janë zakonisht më të lira për njësi sesa prodhimet artizanale apo lokale.

